

ZëRI

Grenelli, kundër reciprocitetit ndaj Serbisë **02**



DITARI Fq.08

SHALJANËT BLOKOJNË RRUGËN, NUK SHFAQËT AGIM BAHTIRI



Kosova ka nevojë për pajisje shtesë për t'u mbrojtur nga koronavirusi **> Faqe 07**

PDK-ja vazhdon bojkotin, Kuvendi seancë të enjten

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka caktuar seancë plenare këtë të enjte për formimin e komisioneve parlamentare. Ashtu si herën e kaluar edhe këtë mbledhje të Kryesisë e ka bojkotuar Partia Demokratike e Kosovës, madje kthimin e tyre në Kryesi PDK-ja e ka kushtëzuar me kthimin e fotografisë së presidentit Thaçi në vendin ku ka qenë. Sipas analistëve, PDK-ja po fshihet pas fotografisë së Thaçit, por bojkoti i tyre po bëhet për arsye të tjera

Marigona Brahimi / Prishtinë

Pas dakordimit në Kryesinë e Kuvendi për krijimin e 14 komisioneve parlamentare, Kuvendi i Kosovës të enjten do të mbajë seancë plenare. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, theksoi se propozimet që janë votuar në mbledhjen e djeshme të Kryesisë për Komisionet Parlamentare dhe për udhëheqjen e tyre do të dërgohen në seancën e së enjtes për votim formal nga deputetët, në mënyrë që komisionet të funksionalizohen. Osmani ka kërkuar

nga grupet parlamentare që deri të mërkurën t'i dërgojnë emrat e anëtarëve të komisioneve në mënyrë që përbërja e plotë e tyre të votohet ashtu siç e cakton Rregullorja. Ajo shtoi se Kryesia është dakorduar që Kuvendi të mbajë seancë për çdo të enjte. "U pajtuam të gjithë që seanca të mbahet të enjten, meqenëse kemi humbur mjaft kohë dhe jemi vonë me shumë vendime të rëndësishme në interes të shtetit. Do të synojmë që për çdo të enjte të mbajmë seanca, përveç kur ka ndonjë zhvillim tjetër", ka deklaruar ajo. **> Faqe 04**

Kultura

"DAM Fest" – i gati për edicionin e 15-të

Marsi sjell në Prishtinë edicionin e 15-të të festivalit "DAM Fest". Të gjithë adhuruesit e muzikës klasike duhet të... **> Faqe 10**

Bota

Pasardhësja e Merkelit heq dorë nga kandidatura për kancelare

Pasardhësja e kancelares Angela Merkel... **> Faqe 09**



Parashikime ambicioze të Kurtit për zhvillimin ekonomik **05**

Ditari

13 vjet pas vrasjes përkujtohen Mon Balaj e Arben Xheladini

Dy aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, Mon Balaj e Arben Xheladini, të cilët humbën jetën në demonstratën e 10 shkurtit 2007, u përkujtuuan gjatë... **> Faqe 03**

Ditari

Vettingu në drejtësi pa opozitën – mision i pamundur

Organizatrat e shoqërisë civile, të cilat monitorojnë punën e sistemit të drejtësisë në Kosovë, thonë se janë... **> Faqe 06**

Sport



Agim Ademi takohet me klubet e pakënaqura të Superligës

Klubet e Superligës së Kosovës në futboll do ta zhvillojnë të martën (sot) një takim me presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim... **> Faqe 14**

Besojeni shëndetin e zemrës suaj më të mirëve.
KORONAROGRAFI
 (jo-urgjente) **350EUR**

Spitali Amerikan
 038 221 661 / 038 400 661
 www.spitaliamerikan.com

eurokoha
 Rezervo tani!

EARLY BOOKING VERA 2020

Tel. 038 235 235 | eurokoha.eu

02

Kurti vizitën e parë zyrtare e bën sot në Shqipëri

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar se vizitën e tij të parë zyrtare do ta bëjë sot në Shqipëri.

Kurti para medieve ka thënë se do të takohet me të gjithë krerët e institucioneve në Tiranë. "Do të ketë takime me krerët e të gjitha institucioneve në Tiranë. Do të ketë diskutime, duke përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor. Ne

do t'i shprehim qëndrimet tona dhe do të flasim pas takimit", tha Kurti para medieve. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte kritikuar më herë kryeministrin e Shqipërisë Edi Ramën për nismën e Mini-Shengenit Ballkanik. Ai kishte pohuar se Shqipëria është dashur të presë formimin e qeverisë së Kosovës për të biseduar për Mini-Shengenin Ballkanik.

Athina akuzon Shkupin për shkelje të Marrëveshjes së Prespës

Ministria e Jashtme e Maqedonisë së Veriut ka marrë një notë proteste nga Ministria e Jashtme e Greqisë për shkelje të Marrëveshjes së Prespës, për emrin e shtetit.

Siç ka bërë të ditur shefi i diplomacisë, Nikolla Dimitrov, Athina zyrtare ka reaguar ndaj një veprimi të ministres së Punës dhe Politikës Sociale, Reshella Mizrahi, meqë në një konferencë për medie mbrapa saj ka qëndruar tabela me emrin e vjetër "Republika e Maqedonisë". "Marrëveshja e Prespës duhet të zbatohet në tërësi. Ajo i hap rrugën anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO dhe kandidaturës së fuqishme të saj për çeljen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian", ka deklaruar Dimitrov duke lexuar pjesë të notës së protestës.

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale Mizrahi është anëtare e VMRO-DPMNE-së, e cila nuk e pranon marrëveshjen e arritur, më 17 qershor të vitit 2018, për ndërrimin e emrit nga "Maqedoni" në "Maqedonia e Veriut".

VMRO-DPMNE-ja është në opozitë, por duke u bazuar në Ligjin për Qeverinë, ajo tani merr pjesë në qeverinë teknike dhe përveç Ministrisë së Punës drejton edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ministri i Punëve të Jashtme, Nikol-

la Dimitrov, ka kërkuar nga ministrja e Punës të largojë tabelën dhe të kthejë të rejën me emrin Maqedonia e Veriut në të kundërtën tha se do t'i kërkojë kryeministrit shkarkimin e saj. "Me këtë akt ajo jo vetëm që shkeli Kushtetutën, por gjithashtu shkeli edhe Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Prespës. Ajo po i nxit marrëdhëniet me Greqinë, po krijon probleme në realizimin e qëllimeve strategjike prej dy dekadash të vendit tonë, anëtarësimin në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale nuk është apartamenti i saj privat, siç nuk është edhe Kushtetuta një copë letër e zakonshme. Asaj mund të mos i pëlqejë, por nuk i jep asaj të drejtën të mos e zbatojë atë", ka deklaruar ministri Dimitrov.

Por në një reagim të Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale hidhen poshtë pretendimet e shefit të diplomacisë. "Është e drejtë demokratike e çdo qytetari të reagojë ndaj padrejtësive. Tabela me emrin e vjetër është i trashëguar, nuk ka asnjë tabelë me emër të ri. Pra, ekziston vetëm një tabelë në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale dhe atë ish-ministres, tani zëvendëskryeministrit për çështje ekonomike, Milla Carovska", ka deklaruar ministrja e Punës, Rashella Mizrahi.

VMRO-DPMNE-ja disa herë ka bërë të ditur se në rast se fiton në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, që do të mbahen më 12 prill, do të nisë menjëherë procedurat për kthimin e emrit të vjetër të shtetit dhe me këtë do të anulojë marrëveshjen me Greqinë.



Eliot Engel i shkruan Shqiprim Arifit: Gjithçka mbetet e paqartë rreth bisedimeve Beograd - Prishtinë

Pavarësisht ndërmjetësimit të SHBA-së për t'i dhënë zgjidhje fazës së fundit Kosovë - Serbi për një marrëveshje të mundshme të paqes, kongresisti amerikan Eliot Engel, i cili është edhe kryetar i Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Marrëdhëniet me Jashtë, po vlerëson se e ardhmja e bisedimeve mbetet e paqartë. Kështu shkruhet në një letër që Engel ia ka nisur kryetarit të Komunitetit të Presheves, Shqiprim Arifit, të cilin e ka ftuar për një takim në Uashington.

Në letrën që e ka publikuar Arifi, Engel shkruan se e ardhmja e bisedimeve për normalizim midis Prishtinës dhe Beogradit mbetet e paqartë. Ai shton se çfarëdo marrëveshje që arrihet duhet të ketë parasysh edhe të drejtat e shqiptarëve në Preshevë. "Edhe pse e ardhmja e bisedimeve për normalizim midis Beogradit dhe

Prishtinës mbetet e paqartë, është e domosdoshme që çdo marrëveshje përfundimtare t'i marrë parasysh të drejtat e shqiptarëve etnikë dhe t'i adresojë mundësitë për rritje ekonomike në Preshevë", shkruan Engel, derisa thotë se personalisht do të angazhohet për të drejtat e banorëve të këtij regjioni. Për të diskutuar rreth kësaj çështjeje Engel e ka ftuar Arifin në Uashington. "Me ftesë të kongresistit, mikut të shqiptarëve, Z. Eliot Engel, njëherësh edhe kryetar i Komisionit të Politikës së Jashtme, do ta vizitoj Kongresin Amerikan në Uashington DC për ta njoftuar z. Engel me situatën aktuale politike në Luginën e Presheves, si dhe do t'i potencoj qëndrimet tona lidhur me zgjidhjen e çështjes së shqiptarëve të kësaj ane për të drejtat individuale dhe kolektive", ka shkruar Arifi.



Grenelli, kundër reciprocitetit ndaj Serbisë

Zëdhënësi i Richard Grenellit, Dick Custin, ka thënë se Kosova duhet ta heqë taksën 100% ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia pa vendosur masën e reciprocitetit

I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell, ka thënë se është kundër masave të reciprocitetit që kryeministri i Kosovës Albin Kurti i ka paralajmëruar kundër Serbisë. Zëdhënësi i tij, Dick Custin, i ka thënë radios "Evropa e lirë" se Grenelli inkurajon Kosovën që ta heqë taksën 100% ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia pa reciprocitet. "Kosova duhet ta heqë taksën ndaj mallrave të Serbisë pa reciprocitet. Jo vetëm ta pezullojë, por ta heqë plotësisht atë", tha Custin.

Custin me këtë rast bëri të ditur se Grenelli nuk e përkrah një masë të tillë. "Ambasadori nuk e mbështet idenë e reciprocitetit", shtoi ai. Kosova u ka vënë taksë 100% prodhimeve të impor-

tuara nga Serbia dhe nga Bosnjë e Hercegovina në nëntor të vitit 2018. Kurti, i cili ka marrë detyrën e kryeministrit javën e kaluar, ka thënë se kjo masë do të zëvendësohet me reciprocitet ndaj Serbisë dhe se reciprociteti do të zbatohet në aspektin ekonomik, tregtar dhe politik.

Zotimi i Kurtit për heqjen e taksës, e cila është bërë shkak i bllokimit të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, ka nxitur reagime të ashpra nga opozita në Kosovë. Kjo ka bërë që Grenelli t'i drejtohet Kadri Veselit, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, subjektit më të madh opozitar, javën e kaluar duke i thënë se taksa ndaj mallrave serbe duhet të hiqet dhe se Kurti ka të drejtë në këtë drejtim.



13 vjet pas vrasjes përkujtohen Mon Balaj e Arben Xheladini

Arbesa Ibrahim / Prishtinë

Dy aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, Mon Balaj e Arben Xheladini, të cilët humbën jetën në demonstratën e 10 shkurtit 2007, u përkujtuuan gjatë ditës së djeshme, me rastin e 13-vjetorit të vrasjes së tyre. Pas homazheve që bëri në Prishtinë, te pllaka përkujtimore e Balajt dhe e Xheladinit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se drejtësia ende nuk është vënë në vend sa i përket kësaj ngjarjeje. Me këtë rast Kurti kërkoi nga UNMIK-u që të marrë masa në këtë drejtim. "Drejtësia ende mungon për Monin e për Arbenin. UNMIK-u duhet të marrë masa dhe të kthejë përgjigje për opinionin e Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut, meqenëse ky panel nxori vendimin që Policia ka pasur faj sa i përket vrasjes së demonstruesve paqësorë", deklaroi ai.

Kjo pasi, siç tha kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, protestën e 10 shkurtit e kishte ndaluar në mënyrë të dhunshme pikërisht Policia Ndërkombëtare e UNMIK-ut. Në kuadër të kësaj ai tha se mbi 200 plumba u hodhën në drejtim të protestuesve, me ç'rast u lënduan mbi 80 persona gjithsej. "232 plumba të skaduar u gjuajtën mbi trupat tanë, u vranë Arben Xheladini e Mon Balaj. Ku do të ishin ata sot po të mos kishte ndodhur ajo padrejtësi këtu e 13 vjet më parë? Do të ishin aktivistë të mirë e qytetarë të ndershëm, patriotë e punëtorë, por jo edhe profiterë. Ata nuk do të kërkonin asgjë, sepse ishin të gatshëm të japin gjithçka. Por ne nuk do të ishim këtu ku jemi po të mos ishin ata", vazhdoi Kurti.

Gjatë fjalimit të tij i pari i Qeverisë së Republikës së Kosovës tha se më 10 shkurt u protestua kundër diskriminimit të shqiptarëve të bërë

në Pakon e Ahtisaarit, e cila u publikua më 2 shkurt të vitit 2007. "Aty 37 herë përmendje fjalë serb, ndërkaq fjala shqiptar një herë, atëherë kur thuhej komunitetet joshqiptare, veçse një herë përmendje edhe gjuha shqipe. Ajo paketë vendosi pengesa të mëdha, që i kemi edhe sot e kësaj dite, shumicën e dyfishtë, dominimin ndërkombëtar përmbi institucionet vendore, shuarjen e TMK-së, decentralizimin etnik", theksoi ai.

Vendimet që u pranuan para 13 vjetësh nga klasa e atëhershme politike, sipas Kurtit, sot i kushtojnë mjaft shumë Kosovës. "Më 10 shkurt 2007 protestuam me shumë të drejtë. Ato vendime që atëherë u pranuan kollaj nga politikanët dritëshkurter sot i kushtojnë shumë Kosovës dhe ia kanë gjymtuar shtetit sovranitetin dhe demokracinë. Ne po përpiqemi ta ndreqim, por korrigjimi e rregullimi marrin shumë më tepër kohë sesa dëmtimi e rrënimi", nënvizoi ai.

Ndaj demonstrata e mbajtur para 13 vjetëve, siç tha shefi i ekzekutivit, nuk ishte e kotë. Përkundrazi, protestat e drejta, siç potencoi kryeministri i Kosovës, e avancojnë drejtësinë. "Një muaj pas protestës sonë Ahtisaari ia bashkëngjiti propozimit të tij një faqe të re, të parë, me rekomandimin ku thoshte pavarësi e mbikëqyrur për Kosovën. Një vit pas protestës u shpall pavarësia e Kosovës e pesë muaj pas protestës së 10 shkurtit OKB-ja vendosi ta ndalojë përdorimin e plumbave të gomës në misionet e saj gjithandej globit", theksoi Albin Kurti.

Mon Balaj dhe Arben Xheladini u vranë gjatë protestës së Lëvizjes Vetëvendosje, e cila u organizua më 10 shkurt 2007. Ata humbën jetën kur pjesëtarët e Policisë së UNMIK-ut qëlluan me plumba gome drejt demonstruesve.



Për më shumë kontakto në: redaksia@zeri.info

ZËRI

Boton: NPIB "Zëri" - Drejtor: SHPENO DOBRANJIA - Gazeta redaktohet nga kolegji i redaksisë - Kryeredaktor: MEHMET GJATA - Redaktorët: SHPATMAL KRASNOSI (Sport) - ARGJENDA SELMANI (Kulturë, Fjalëtorësi) - LULZIM XHEMA (Zif) - GENT SELANI (Cendra Grafike) - LAURA HASANI (Fotografia) - Drejtor financiar: ISMAIL MUSLIU - Drejtor i marketingut: HEKURAN HOXHA - Marketingu: (038) 249 751 - E-mail: marketingu@zeri.info - Xhilotlogaria: NLB Prishtina Nr. 1701001010829163 - Adresa e redaksisë: Pallati i shtypit p. n. / Aneksi, Prishtinë - Tel/Fax: (038) 249 071, Tel: (038) 222 451, mob: (044) 951 515 - E-mail: redaksia@zeri.info dhe zeri_d@hotmail.com - Shtypet në shtypshkronjën: "Lindi Printing Center" - Dorëshkrimet nuk kthehen

eurokoha

Fluturoni tërë botën me çmime speciale!

Prishtinë
« Amsterdam
Prishtinë
prej **220€**

Prishtinë
« Ljubljane
Prishtinë
prej **160€**

Prishtinë
« Dubai
Prishtinë
prej **410€**

Prishtinë
« Londër
Prishtinë
prej **220€**

Prishtinë
« Copenhagen
Prishtinë
prej **235€**

Prishtinë
« Singapur
Prishtinë
prej **900€**

Prishtinë
« Zagreb
Prishtinë
prej **205€**

Prishtinë
« New York
Prishtinë
prej **540€**

Prishtinë
« Washington
Prishtinë
prej **550€**

Prishtinë
« Toronto
Prishtinë
prej **630€**



Na kontaktoni
www.eurokoha.eu
Tel. 038 235 235

Ditari

PDK-ja vazhdon bojkotin, Kuvendi seancë të enjten

Vijon nga faqja e parë

Mirëpo mbledhja dhe të gjitha propozimet janë bërë në mungesë të Partisë Demokratike të Kosovës. Grupi Parlamentar i PDK-së për të dytën herë radhazi e bojkotoi mbledhjen e Kryesisë pasi kryetarja e Kuvendit kishte zhvendosur fotografinë e presidentit Hashim Thaçi nga vendi ku qëndronte në zyrën e saj, gjë që sipas PDK-së, përbën shkelje ligjore. Madje nga kjo parti kanë kështuuar kthimin e tyre në Kryesi me kthimin e fotografisë së Thaçit në vendin ku ka qenë. Ky veprim i PDK-së sipas analistëve ka arsye të tjera. Ata theksojnë se nëse PDK-ja e konteston zgjedhjen e Osmanit si kryeparlamentare për këtë duhet t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese dhe jo t'i bojkotojnë institucionet e vendit.

Kuvendi, me 14 komisione parlamentare

Të enjten Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë plenare për formimin e komisioneve parlamentare. Siç ka njoftuar kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, deputetët fillimisht duhet të votojnë me dy të tretat e votave për zvogëlimin e numrit të komisioneve parlamentare në 14, dy më pak sesa kanë qenë në legjislaturën e kaluar. Legjislatura e shtatë e Kuvendit do t'i ketë këto komisione:

Komisioni për Punë të Jashtme dhe për Diasporë do të udhëhiqet nga AAK-ja, Komisioni për Integrim Evropian nga LDK-ja, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion nga LDK-ja, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport nga LDK-ja, Komisioni për Buxhet dhe Financa nga LVV-ja, Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Medie nga PDK-ja, Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike nga Nisma, Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes nga LVV-ja, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga AAK-ja, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis nga LVV-ja, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nga Lista Serbe, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione nga Grupi 6 Plus, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nga PDK-ja, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë nga PDK-ja.



FOTO: LAURA HASANI

Për fotografinë e Thaçit PDK-ja sërish bojkoton Kryesinë e Kuvendit

Mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit dje për të dytën herë radhazi Partia Demokratike e Kosovës e ka bojkotuar për shkak të zhvendosjes së fotografisë së presidentit Hashim Thaçi nga vendi i mëparshëm në zyrën e kryetares së Kuvendit dhe zëvendësimit të vendit të fotografisë së tij me atë të ish-presidentit Ibrahim Rugova nga vetë kryeparlamentarja.

Partia e Kadri Veselit e ka kështuuar kthimin në mbledhje të Kryesisë me kthimin e fotografisë së presidentit Thaçi në vendin ku ka qenë. Përmasë një shkresë zyrtare drejtuar Osmanit, PDK-ja ka theksuar se ky bojkot është veprim simbolik e politik ndaj shkeljeve ligjore, që Osmani ka bërë me rastin e heqjes së fotografisë zyrtare të presidentit të Kosovës. Kështu PDK-ja ka kërkuar që Osmani ta kthejë sa më parë fotografinë e presidentit Thaçi në vendin ku ka qenë dhe të distancohet nga këto veprime, në të kundërtën PDK-ja paralajmëron pasojë në jetën institucionale. "Ju inkurajojmë ta ktheni fotografinë e presidentit në pjesën ballore të zyrës dhe të distancoheni nga qasja jointucionale dhe të mos krijoni një precedent të tillë, i

cili do të ketë pasojë jo vetëm në nivel të zhvillimit të jetës institucionale dhe politike në planin afatshkurtër, por edhe do të ketë pasojë afatgjatë në aspektin e zhvillimit dhe të kultivimit të kulturës shtetërore, kushtetuese dhe parlamentare në demokracinë tonë të re" thuhet në shkresën e PDK-së drejtuar Osmanit.

PDK-ja po fshihet pas fotografisë së Thaçit, bojkoti për qëllime të tjera

Kryekuvendarja Vjosa Osmani e ka quajtur politik bojkotin e PDK-së ndaj mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. Ajo thotë se me bojkotin e saj PDK-ja po fshihet pas arsyetimeve për shkelje ligjore, por në fakt arsytet janë tjera. Sipas saj, PDK-ja ka nisur bojkotimin e institucioneve të vendit që nga 3 shkurti, ende pa u lëvizur fotografia e presidentit. "PDK-ja ka nisur bojkotin ndaj institucioneve më 3 shkurt. Por nëse tash gjejmë arsytet me si e dekoroj unë zyrën time le të përdorin arsytet e tilla, sepse nuk e gjejmë guximin ta tregojnë të vërtetën. Bojkoti i tyre ka filluar në mëbrëmjen kur u votua Qeveria e Kosovës dhe unë si kryetare e Kuvendit. Pra bojkoti i tyre është politik dhe nuk ka asnjë lidhje tjetër me temat, që po i përdorin si arsytet", ka deklaruar ajo.

Sipas analistëve, PDK-ja po e konteston zgjedhjen e saj si kryetare Kuvendi pa dorëheqjen e Glauk Konjufcës, i cili e mbante këtë pozitë. Kështu ata theksojnë se PDK-ja mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën Kushtetuese mbi mënyrën se si është zgjedhur ajo. Por Osmani theksoi se nëse ndonjë deputet ose grup parlamentar ka dyshime mbi procedurën se si ajo është zgjedhur, ka të drejtë të ankohet në organet kushtetuese, porse edhe pas shkarkimit të saj Vetëvendosja si partia më e madhe në përputhje me marrëveshjen politike me LDK-në do ta propozonte sërish atë për kryeparlamentare. Prandaj, ajo thekson se kjo vetëm do të merrte kohë. Edhe njohësi i çështjeve politike Blerim Vela ka deklaruar se nëse PDK-ja dëshiron ta kontestojë zgjedhjen e Osmanit si kryeparlamentare le të ankohet në Gjykatën Kushtetues, por të mos fshihet pas fotografisë së presidentit Thaçi. "Nëse PDK-ja ka për qëllim ta kontestojë në Gjykatën Kushtetuese zgjedhjen e Vjosa Osmanit si kryeparlamentare, nuk ka nevojë të fshihen pas çështjes së portretit të presidentit për ta bojkotuar punën e Kryesisë së Kuvendit dhe autoritetin e kryetares së Kuvendit. Duhet ta thotë troç nëse e njohin atë si kryetare legjitime të Kuvendit. Përndryshe, parimësisht e PDK-së do të testohet nëse mosnjohja e tyre e autoritetit të kryetares së Kuvendit nënkupton edhe bojkotim të seancave plenare", ka përfunduar Vela.

Ditari

Parashikime ambicioze të Kurtit për zhvillimin ekonomik

Reformat e parapara nga kreu i Qeverisë së Kosovës Albin Kurti në sektorin e ekonomisë nga njohësit e çështjeve ekonomike janë duke u parë si ambicioze, por të realizueshme, ndërsa si dëshira të pamundura nga partitë opozitare të vendit. Kurti ndër të tjera ka premtuar mbylljen e AKP-së, bashkimin e Doganës me ATK-në, si dhe rritjen e buxhetit deri në tre miliardë euro për një vit

Valmire Maliqi / Prishtinë

Në seancën, kur mori detyrën e re si kryeministër i vendit, Albin Kurti ndër synimet me parësore shpërfaqti reforma ambicioze në sektorin e ekonomisë, nëpërmjet të të cilave do të dinamizohet zhvillimi ekonomik i vendit. Mbyllja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, bashkimi i Administratës Tatimore të Kosovës me Doganën, rritja e buxhetit deri në tre miliardë euro, si dhe programi për 8 orë punë janë disa nga synimet e qeverisë "Kurti" për reforma në ekonomi. Për njohësit e çështjeve të ekonomisë synimet e paraqitura nga Kurti për reforma rrënjësore në ekonomi po shihen ambicioze, pavarësisht se realizimi i tyre varet edhe nga jetëgjatësia e Qeverisë. Nga përfaqësuesit e partive opozitare këto synime të Kurtit po shihen vetëm si dëshira personale.



FOTO: LAURA HASANI

Reformat e premtuara në ekonomi

Partnerët e koalicionit LVV - LDK për bashkëqeverisje janë dakorduar që për ta zhvilluar ekonominë e vendit të bëjnë reforma në disa pika. Një ndër synimet më madhore është ai për rritjen e buxhetit deri në 3 miliardë euro gjatë qeverisë "Kurti". Zvogëlimi i ndërmarrësisë në tërësi dhe me fokus të veçantë për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe për industrinë prodhuese është një ndër synimet kyçe të kësaj reforme. Si rrjedhojë e kësaj reforme Agjencia Kosovare e Privatizimit pritet të shuhet dhe të krijohet një agjenci brenda Qeverisë. Më saktësisht, me pajtimin e partnerëve të koalicionit është paraparë të krijohet Fondi Sovran, i cili do t'i marrë në pronësi pronat strategjike të Kosovës. Kjo nënkupton edhe krijimin e mundësive për investime jashtë vendit, si dhe gasje në tregje të huaja të kapitalit. Përveç këtij Fondi, pritet të formohet edhe Fondi Zhvillimor bazë e të cilit janë mëtet financiare të privatizimit dhe burime të tjera. E një fond tjetër është edhe Fondi Garantues i Kredive e që për qëllim ka garantimin e kredisë duke ulur kështu nevojën e kreditimit për bizneset vendore. Politikat e punësimit po ashtu janë të përfshira në planin zhvillimor për ekonomi. Sipas

dakordimit të arritur nga partnerët e koalicionit në këtë sektor më shumë do të përqendrohen në punësimin e të rinjve dhe të grave. Ndërsa në planin zhvillimor për ekonomi është paraparë dhe krijimi i grantit të katërt për komuna. Ky grant do të fokusohet për investimet kapitale. Ndër reformat që pritet të ndodhin janë edhe ndryshimet tatimore e ku priten edhe ndryshime në Ligjin për të Ardhurat Personale. Në kuadër të këtyre ndryshimeve hyjnë edhe ndryshimet për mbledhjen e TVSH-së brenda vendit, si dhe heqja e të gjitha kufizimeve për konkurrencën e lirë. Pjesë e rëndësishme e këtij projekti është edhe programi për 8 orë punë, ku çdo punëtor duhet të punojë 8 orë në ditë dhe 40 orë në javë sipas ligjit. Qeveria "Kurti" ka theksuar se për ta arritur këtë qëllim do ta shtojë numrin e inspektorëve deri në 400, ndërsa është theksuar se do të nisim themelimin e një programi nacional të kursimit katërvjeçar.

Kadrijaj: Në Kosovë reformat në ekonomi varen nga jetëgjatësia e qeverive

Njohësi i çështjeve ekonomike Mustaf Kadrijaj në një deklaratë për "Zërin" e ka quajtur optimist planprogramin e qeverisë "Kurti" për zhvillimin ekonomik. Sipas tij, funksionalizimi ose jo i këtij plani varet nga vullneti i qeverisë

së re. "Është e normale se çdo kryeministër vjen në pushtet me një ofertë për qytetarët dhe është normale se ai ka disponim ta jetësojë këtë plan. Tani kur flasim ka vetëm pak ditë që ka marrë mandatin si kryeministër z. Kurti dhe ne nuk duhet të jemi paragjykuar, duhet të presim se si do t'i qaset dhe sa do të jetë serioz në jetësimin e këtyre reformave", ka thënë ai.

Kësisoj, sipas tij, nëse shihet prapa në Kosovë partitë politike kanë dëshuar t'i jetësojnë planet për zhvillim ekonomik si pasojë e moszgjatjes së qeverisjes së tyre. "Një gjë është dëshmuar që nga paslufta, sado që të jetë e parashikuar mirë reforma, nëse nuk ka jetëgjatësi qeveria vetëm do të krijonte paqartësi në administrim, sepse ta bëjë bashkimin e Doganës dhe të ATK-së dhe të krijojë Fond për Kreditim, si dhe ta shuash AKP-në ka edhe një dozë të riskut, pasi nëse dështon ose menaxhohet jo mirë do të bëhet edhe më keq, përdërisa qytetari ia ka dhënë besimin për një qeverisje më të mirë", është shprehur ai.

Kësisoj sipas tij ekziston rreziku, sado i vogël qoftë ai që ndryshimet thelbësore që planifikohen dhe të mos ecin sipas planit qeveritar. "Pra, nga këndvështrimi i një ekonomisti, çdo ndryshim ka një dozë të frikës, sepse një veprim politik bën gabime që do kohë për t'u sanuar. Çka do të bëhej nëse nuk funksionon autoriteti i ri i

bashkuar ATK - Dogana, po ashtu nëse shuhet AKP-ja çka do të bëhej edhe me ato pak pasuri që nuk janë privatizuar ende. A do t'i ktheheshin ato në pronë shtetërore, që s'do mend se do të ishte si ndërhyrje majtiste në të qeverisurit. Po ashtu ka pa qartësi edhe me krijimin e Fondit, kush do ta themelojë, Qeveria apo Parlamenti? Kush do ta mbikëqyrë, cili sektor do t'i përkrahë, si do t'i krijojë të hyrat ky Fond? Pra është një veprim më shumë të panjohura, që pavarësisht dozës së frikës për jetësim nuk dua të paragjykoj, kështu që uroj që të kemi një qeveri ashtu siç është deklaruar", ka shtuar tutje Kadrijaj.

Shatri: Synimet e Albin Kurtit - thjesht janë dëshira

Ish-ministri i Financave, si dhe njëherësh këshilltari i ish-kryeministrit Ramush Haradinaj për çështje të ekonomisë, Haki Shatri, synimet për reforma në ekonomi të paraqitura nga kryeministri aktual Albin Kurti i ka cilësuar vetëm dëshira. "Ai i ka paraqitur disa synime e që janë dëshira. Kjo do të thotë se thjesht janë dëshira, sepse ashtu siç janë paraqitur ato shihen si dëshira të mira, që do të kisha pasur dëshirë të realizohesh. Për t'u realizuar këto duhet të ketë një analizë të mirëfilltë, të bazuar në bazën materiale të realizimit të atyre synimeve e që nuk e kemi parë", ka thënë Shatri.

Sipas tij, ka një dallim të madh në mes të asaj që është e ditur dhe e shkruar në letër dhe asaj çfarë dëshiron një njeri, duke aluduar kështu në pikat e reformës për ekonomi që i ka paraqitur kryeministri. "Ne e kemi buxhetin dhe e kemi këtë ekonomi që e kemi me këtë aftësi akumuluese që e kemi dhe ajo pa marrë parasysh se çfarë shkruhet në letër, ajo nuk ndërron, është po ajo që është. Edhe dëshira më e madhe e njeriut është vështirë të realizohet, sepse nuk po shoh bazë materiale. Është dashur të bëhet një analizë e mbështetur në parametra, të cilët e garantojnë realizimin e atyre synimeve. Këto ne nuk i kemi parë. Ato janë vetëm dëshira të paraqitura në ndonjë rast solemn. Të shohim kur të vijë programi se si do të prezantohen ato synime", ka thënë ai.

Ditari

Vettingu në drejtësi pa opozitën - mision i pamundur

Sistemi i drejtësisë në Kosovë, sipas raporteve të parvjetshme të progresit të Komisionit Evropian, nuk ka arritur ende të pavarësohet nga ndikimi i politikës. Edhe procesi i vettingut shihet me rreziqet e veta, për shkak të mundësisë së ndikimit të Qeverisë në drejtësi

Organizatave të shoqërisë civile, të cilat monitorojnë punën e sistemit të drejtësisë në Kosovë, thonë se janë të gatshme t'u ofrojnë ndihmë institucioneve përgjegjëse në procesin e vettingut në drejtësi me këshilla e rekomandime, por jo të bëhen pjesë e atij procesi.

Përfaqësues të shoqërisë civile thonë se i mbështesin deklaratat e kryeministrit Albin Kurti dhe të ministres së Drejtësisë Albulena Haxhiut për nisjen e procesit të verifikimit në drejtësi, por i bëjnë thirrje Qeverisë që të mos marrë hapa të shpejtë ngase për të pasur sukses ky proces kërkon edhe mbështetjen e opozitës dhe të Kuvendit të Kosovës.

Kryesisht Grupi për Studime Juridike, Politike dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi ndër vite kanë bërë thirrje që procesi i vettingut, ose i verifikimit, të ndodhë sa më parë në mënyrë që të rritet efikasiteti në sistemin e drejtësisë.

Kompetenca për realizimin e vettingut i takon Qeverisë së Kosovës

Në Grupin për Studime Juridike, Politike thonë se sistemi i drejtësisë patjetër duhet t'i nënshtrohet një procesi të vettingut ose të verifikimit në tërësi.

Reze Hoxha, nga Grupi për Studime Juridike, Politike, thotë për REL-in se kompetenca për realizimin e procesit të vettingut i takojnë Qeverisë së Kosovës, kurse shoqëria civile mund të ofrojë ekspertiza dhe monitorim sistematik. "Grupi për Studime Juridike, Politike tashmë ka përgatitur një propozim, i cili do të bëhet shumë shpejt publik. Do t'i dërgohet Qeverisë dhe do të ndahet edhe me medie, edhe me partnerët e tjerë. Raporti tregon se cilët janë hapat

e parë që do të duhej të ndërmerren në krijimin dhe në aktualizimin e një procesi të vettingut", tha Hoxha.

Sipas Hoxhës, analiza e cila pritet të publikohet tregon edhe për kriteret, të cilat duhet të kërkohen për zyrtarët që punojnë në sistemin e drejtësisë. Ajo thotë se procesi i vettingut duhet të jetë një mekanizëm, të cilin duhet ta përballojë çdo qeveri, në të kundërtën nuk mund të priten suksese.

Plani për vettingun në drejtësi, nënvizon ajo, duhet të jetë një plan shumë më i gjerë dhe i pranueshëm nga spektri më i gjerë politik dhe jo vetëm nga partnerët e koalicionit qeverisës. "Nuk do të duhej të ishte vetëm kompetencë e Qeverisë ose të themi të pushtetit ekzekutiv, duke marrë parasysh se këtu duhet përfshirë edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës si institucioni kryesor legjislativ në vend, pasi aty janë të përfaqësuar të gjitha partitë politike", thekson Hoxha.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë, sipas raporteve të parvjetshme të progresit të Komisionit Evropian, nuk ka arritur ende të pavarësohet nga ndikimi i politikës. Edhe procesi i vettingut shihet me rreziqet e veta, për shkak të mundësisë së ndikimit të Qeverisë në drejtësi.

Sipas Hoxhës, për këtë arsye nevojitet që i gjithë procesi të monitorohet nga afër. "Për më tepër, që të evitohet një faktor i tillë do të duhet të kërkohet edhe konsensusi politik, i cili do të përfshijë edhe partitë opozitare", tha Hoxha.

Sistemi gjyqësoro-prokurorial në praktikë nuk ka arritur ta ruajë pavarësinë

Ndërkaq Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi,



thotë se sistemi gjyqësoro-prokurorial në aspektin e funksionimit, të operimit dhe të llogaridhënies është tërësisht i pavarur nga politika, por në praktikë nuk ka arritur ta ruajë pavarësinë. Sa i takon procesit të vettingut, ai thotë se nga të gjitha qeveritë që i ka pasur Kosova, ka pasur shumë premtime për vettingun, por asgjë deri tash nuk është realizuar. Miftaraj thekson se vettingu nuk mund të mendohet e nuk mund të bëhet pa ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. "Procesi i vettingut në asnjë rrethanë nuk guxon të fillojë pa ndryshime kushtetuese, që nënkupton se nevojiten së paku 80 vota të deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Vetëm pasi të ketë një koordinim të duhur me faktorin ndërkombëtar dhe me opozitën mund të fillojë procesi i vettingut. Ajo çka ne si Institut i Kosovës për Drejtësi e kemi parë, është që kjo Qeveri siç duket vettingun e ka prioritet dhe së paku nga ajo që kemi pasur takime dhe që është thënë në publik, kjo Qeveri e ka kuptuar se sistemi i drejtësisë në Kosovë pastrohet vetëm përmes procesit të vettingut, i cili duhet të jetë i drejtë", tha Miftaraj.

Ai tha se për të vazhduar procesin e vettingut, instituti të cilin e drejton, mund të ofrojë dokumente, monitorime e hulumtime të cilat mund të merren si bazë për procesin e të cilat tregojnë për shkeljet të shumta që ndodhin në Prokurori e nëpër gjykata.

Rrjedhimisht, thotë Miftaraj, roli i shoqërisë civile në këtë proces mund

të jetë vetëm ndihmues, udhëzues dhe këshillëdhënës. "Institut i Kosovës për Drejtësi ka mbi 70 raporte, në të cilat janë identifikuar të metat e sistemit të drejtësisë në Kosovë, problemet që kanë të bëjnë me profesionalizimin, me integritetin, qoftë institucional, qoftë personal të krerëve të sistemit të drejtësisë dhe të sigurisë, të cilat mund të shërbejnë si bazë e mirë jo vetëm për këtë Qeveri, por për të gjitha partitë politike e për publikun në Kosovë, që të përmirësohet sistemi i drejtësisë në Kosovë", tha Miftaraj.

Ministria e Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, Albulena Haxhiu, është zotuar se çështja e vettingut do të jetë prioritet në angazhimin e saj si ministre. "Unë besoj se sistemi i drejtësisë nis të çlirohet në momentin kur ne e adresojmë vettingun. Besoj se kjo do të jetë njëra prej sfidave më të mëdha më të cilën do të ballafaqohet Ministria e Drejtësisë", ka deklaruar Haxhiu.

Besimi i qytetarëve ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë është luhatur ndër vite, por asnjëherë si deri më tani besimi nuk ka qenë në nivelin me të ulët, kanë thënë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Institucionet e Kosovës, në veçanti mekanizmat e drejtësisë, janë ndihmuar ndër vite edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë, fillimisht nga Misioni i Kombeve të Bashkuara - UNMIK e më pas nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX.

Ditari

Kosova ka nevojë për pajisje shtesë për t'u mbrojtur nga koronavirusi

Mbi 900 persona së fundmi është raportuar se kanë vdekur nga koronavirusi, i cili po përhapet furishëm në shumë shtete. Për t'u mbrojtur e për t'i trajtuar rastet në rast të përhapjes së këtij virusi në vend institucioneve shëndetësore do t'u duhen më shumë mjekë e mjete

Arbresha Berisha / Prishtinë

Përhapja e virusit vdekjeprurës "Korona" po vazhdon të rritet në Evropë, duke rrezikuar edhe Kosovën. Persona të shumtë nga Kosova, të cilët shkojnë për vizita në shtetet tjera ku ka të prekur me këtë virus e që pastaj kthehen në vend rrezikojnë të preken me koronavirusin, i cili pastaj shumë lehtë mund të bartet edhe te qytetarët tjerë.

Për t'u mbrojtur nga ai nga institucioneve e shëndetësore në vend thuhet se janë të furnizuara me pajisje të nevojshme, mirëpo ditë më parë u ironizua se mjekët kosovarë nuk janë të përgatitur për t'u ballafaquar me virusin kinez. Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore, Arsim Gërxfaliu, është shprehur se maskat që po përdoren nga mjekët nuk mund ta ndalin koronavirusin.

Nga Klinika Infektive në QKUK është thënë se momentalisht janë furnizuar me disa pajisje të nevojshme dhe në rast të paraqitjes së rasteve të prekura me virus do të furnizohen edhe me pajisjet tjera. Përveç pajisjeve, problematikë është edhe mungesa e personelit mjekësor në vend. Nga Klinika Infektive është thënë se në rast të përhapjes së koronavirusit do të kërkojnë ndihmë edhe nga infektologët në spitalet rajonale, përderisa vetë këto spitale kanë mungesë të konsiderueshme të stafit.

S'ka raste të dyshuara me koronavirus në Kosovë, mjekët marrin masa

Infektologu në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka thënë për "Zërin" se momentalisht nuk kanë asnjë rast të dyshuar me koronavirus. Ai ka përmendur edhe pacienten britanike, e cila ditë më parë u dyshua të jetë e prekur me virusin vdekjeprurës, me ç'rast ka theksuar se ajo është liruar nga klinika. "Unë mund t'ju konfirmoj se në Klinikën Infektive nuk kemi asnjë rast të dyshuar që është i prekur me koronavirus, në përjashtim të një rasti i cili ishte i dyshimtë, por edhe ai ka rezultuar se nuk është dhe pacientja është liruar. Ajo ka qëndruar 24 orë dhe nuk ka pasur nevojë të qëndrojë më shumë. Gjendja e përgjithshme e saj ka qenë shumë e mirë", ka thënë ai.

Sa u përket pajisjeve të nevojshme dhe përgatitjeve, ai ka bërë të ditur se Klinikën është në vazhdimësi duke përcjellë



Fakte

QKUK-ja punëson dy kardiokirurgë të rinj

Pas dorëheqjes së dy kardiokirurgëve, Raif Çavollit dhe Arbër Kutllovcit, Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka punësuar dy kardiokirurgë të rinj. Dr. Ramë Alaj dhe Kushtrim Shala janë punësuar me konkurs në Klinikën e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive. Ramë Alaj ka kryer provimin specialistik në Kardiokirurgji në dhjetor të vitit të kaluar. Dy kardiokirurgët, Çavolli dhe Kutllovci, kishin dhënë dorëheqje nga klinika ku punonin, për shkak të pakënaqësive që kishin pasur.

rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Sipas tij, janë duke u bërë përgatitjet se ku do të lajmërohet pacienti, i cili dyshohet të jetë me koronavirus e çfarë tretmani do të ketë. "Për fazën në të cilën jemi, ne kemi pajisjet e nevojshme për t'u ballafaquar me rastet e mundshme. Nëse paraqiten raste, atëherë edhe niveli i gatishmërisë rritet në një shkallë më të lartë. Ne i kemi maskat e nevojshme dhe kemi aparaturën e nevojshme. Stafit është i njoftuar dhe janë bërë përgatitjet se ku do të lajmërohet pacienti nëse është i dyshimtë, pastaj si duhet të qarkullojë brenda Klinikës, çfarë analizash duhet të merren e çfarë

tretmani duhet të ketë", ka potencuar ai.

Krasniqi ka thënë se pajisjet tjera të nevojshme për koronavirusin mund të vijnë vetëm në rast të paraqitjeve të rasteve që konfirmohen.

Apelohet që qytetarët të njoftohen më shumë se si duhet ta menaxhojnë situatën

Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Blerim Syla, ka apeluar te Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në vend që t'i njoftojë më shumë qytetarët se si duhet të menaxhohet situata sa i përket koronavirusit. Ai ka thënë se masat mbrojtëse duhet të jenë më të rrepta gjithkund, jo vetëm në Institut e në Klinikën Infektive. "Sa kam lexuar, virusi është një nga 400 llojet të cilat ekzistojnë. Klinika Infektive ka staf, i cili është i përgatitur. Nuk kanë ngelur asgjë prapa. Ajo çfarë unë apeloj është që sa më shpejt Instituti edhe pse ka dalë me programin e vet, ta njoftojë pak më shumë popullatën se si duhet të menaxhohet situata. Besoj se masat mbrojtëse duhet jenë pak më të rrepta, jo vetëm në Infektivë e në Institut, por në të gjitha pikat", ka thënë ai.

Nga Klinika Infektive është thënë për gazetën më herët se në rast të përhapjes së koronavirusit në vend do të kërkojnë staf edhe nga spitalet rajonale. Syla ka thënë se këto spitale kanë staf mangët, porse do të angazhohen edhe ata mjekë që janë. "Se sa kemi mjekë nëpër spitale

rajonale po dihet tani se ne kemi staf mangët, meqë infektologë nuk kemi. Por ata që janë duhet të inkuadrohen nëse vjen deri te kjo situatë. Ne duhet të dimë se në situata të tilla të gjithë mjekët angazhohen. Shpresoj të mos vijë deri te një pandemi e tillë", ka theksuar ai.

Mbi 900 persona të vdekur e mbi 40 mijë të prekur nga koronavirusi

Numri i personave të vdekur nga koronavirusi ka shkuar në mbi 900, kështu është rritur edhe numri i të prekurve me të. Raportohet se numri i personave nën vëzhgimin mjekësor është rritur në 187 mijë e 518, ndërsa numri i atyre që mendohet se janë të infektuar qëndron në mbi 40 mijë. Autoritetet në Kinë kanë bërë të ditur se janë raportuar 40 mijë e 171 raste të konfirmuara, ndërsa gjatë të dielës 97 persona kanë vdekur dhe mbi 3 mijë raste të reja janë zbuluar. Virusit është përhapur në më shumë se 24 vende të tjera, duke përfshirë në SHBA, Singapor, Francë, Gjermani, Itali, Suedi, Rusi, Spanjë dhe Indi.

Qeveria e Britanisë së Madhe e ka shpallur koronavirusin kërcënim serioz dhe të pashmangshëm për shëndetin publik. Ministri i Shëndetësisë, Matt Hancock, ka njoftuar se kjo masë është marrë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit publik nga përhapja e mundshme e virusit të rrezikshëm.

Ditari

Shaljanët bllokojnë rrugën, nuk shfaqet Agim Bahtiri

Rreth 150 banorë të Shalës së Bajgorës kanë bllokuar përrreth 40 minuta rrugën kryesore, e cila dërgon në Mitrovicë, të pakënaqur me punësimin e fundit të punëtorëve në "Trepçë". Shaljanët i ka përkrahur kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, por qytetarët e fshatrave të Mitrovicës thonë se Bahtiri ka futur përçarje në mesin e popullatës së Shalës së Bajgorëve dhe të tjerëve. Ibrahim: Prodhimi në "Trepçë" është rritur 20 për qind

Kajtas Gecaj / Stan Tërg

Paralajmërimi i banorëve të Shalës së Bajgorës për protestë në shenjë pakënaqësie për punësimet e fundit në "Trepçë" është realizuar të hënën. Rreth 150 banorë të Shalës së Bajgorës kanë bllokuar përrreth 40 minuta rrugën kryesore, e cila dërgon në Mitrovicë, të pakënaqur me punësimin e fundit të punëtorëve të "Trepçë", që siç thonë shaljanët, është bërë me nepotizëm. Protestuesit kanë thënë se Shala është anashkaluar gjatë punësimit të fundit në "Trepçë", ndonëse shumë të papunë të kësaj ane kanë aplikuar me kohë. Sipas tyre, menaxhmenti i "Trepçës" ka punësuar njerëz nga vende tjera, duke përfshirë Skenderajn dhe Vushtrinë. Organizatori i protestës, Arsim Musa, i ka ftuar të gjithë shaljanët nëpërmes "Facebook"-ut të dalin në protestë dhe të protestojnë kundër punësimeve në "Trepçë".

Shaljanët: "Trepça" është pasuri e Shalës, ata kanë përparësi në punësim

Gani Hajdari, një banor i Shalës, ka shkruar në "Facebook" se disa parti politike kanë harruar se "Trepça" dhe Stan Tërgu janë rajon i Shalës. "Është pasuri e Shalës edhe ata kanë përparësi në punësim, sepse përparësi kanë pasur brez pas brezi. Ata e kanë mbajtur këtë minierë e tash të mos i pranojnë në punë është mëkat i madh dhe ai komision do të ketë përgjegjësi. Të vetmin burim në shaljanët e kemi këtë minierë, ai komision lë të zhduket me gjithë menaxhmentin, i cili deri sot nuk ka ditur ku është miniera dhe kush janë ata që punojnë aty", ka thënë ai.

Në përkrahje të protestës ka dalë edhe kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, i cili ka deklaruar se mbështet fuqishëm shaljanët në kërkesat e tyre. Ai e ka vlerësuar ndërmarrjen "Trepça" për kontributin e saj në zhvillimin ekonomik të vendit, por siç ka thënë ai, "ndërhyrja e politikës ka anashkaluar minatorët që me sakrificë të lartë shpëtuan ndërmarrjen nga fundosja menjëherë pas luftës". "Kombinati 'Trepça' gjithmonë ka qenë promotori kryesor i zhvillimit ekonomik të Mitrovicës, por edhe i mbarë Kosovës. 'Trepça' ka pasur prodhim të lartë, duke sjellë kështu profit të madh për vendin. Kjo për arsye sepse



është punuar drejt, është punuar pa hile. Punëtorët janë kujdesur për minierën sikurse për shtëpinë e tyre, sepse realisht edhe ka qenë shtëpia e tyre e dytë. Fatkeqësisht, shumë shpejt pas kësaj filloi implikimi i politikës në punën e minierës dhe u harrua kontributi i minatorëve vendas dhe dalëngadalë ata u zëvendësuan me të dëgjueshmit dhe me servilët partiakë nga anembanë Kosova. Shaljanët u anashkaluan krejtësisht dhe në vend të punësimit shpërbleheshin me premtime të rrejshme. Kursesi nuk pajtohem me ndarje krahinore, por gjithsesi nuk mund të pajtohem as me injorim të tillë që i bëhet Shalës nga paslufta. Pajtohem dhe mbështes fuqishëm protestën me anë të së cilës shaljanët kërkojnë drejtësi dhe barazi, sepse ky duhet të jetë synimi kryesor në shoqërinë tonë", ka shkruar vetëm një ditë para protestës kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri.

Banorë të tjerë: Po duan të na përçajnë dhe të na ngatërrojnë mes vete

Por me Agim Bahtirin nuk janë pajtuar banorë të fshatrave të tjera të Mitrovicës, madje ata e quajnë Bahtirin si një përçarës, i cili dëshiron t'i ngatërrojë mes vete shaljanët. "Unë jam i Koshtovës dhe nuk paskam hisë në 'Trepçë' a, as ai i Zhabarit, as ai i Vaganicës, as asnjë tjetër, veç Shala. Marre për ty o Agim Bahtiri, fëmijët e mi po u dashka me vdesë urie se s'po u bajka me hi në punë në 'Trepçë'. Deri këtu na paska sjellë politika e jote qorre", ka thënë një banor i Koshtovës, ndërsa Ardiana Begu u shpreh se qëllimi

është të futet përçarje në mes njerëzve. "Shaljanët kundër shaljanëve, 97 veta nga 120 janë pranuar në punë të Shalës e ky Agim Bahtiri nuk paska mundur ta shtijë në punë asnjë të Gushavcit, as të Lushitës, as të Zhabarit, as të Kosthovës, as të Kçiçit. Mos bre se marre me këto ndarje, po doni me na shti Shalën me u përta mes vete. Tash po dëshironi me na shti kundër 97 shaljanëve që qenkan hyrë në punë. 'Trepça' më së pari është e Kosovës, e të gjithë shqiptarëve, e këtij Agim Bahtirit s'i ka mbetur tjetër veç me i shti shaljanët mes vete, po edhe të tjerët", thotë ajo.

Në anën tjetër kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, nuk është dukur fare në protestën e organizuar nga shaljanët, të hënën, në rrugën kryesore që çon nga Shala për Mitrovicë, ku ajo ishte bllokuar përrreth 40 minuta. Një grup i protestuesve pas përfundimit të protestës janë pranuar në bisedë të drejtori menaxhues i "Trepçës", Basri Ibrahim, i cili ka dëgjuar ata për pakënaqësitë e tyre.

"Trepça" kishte shpallur konkurs për pranimin e 230 punëtorëve të rinj në pozita të ndryshme, si punëtorë në flotacion (Tuneli i Parë) dhe në minierën e "Trepçës" në Stan Tërg. "Trepça", e cila pranon e ka shtetin e Kosovës, pavarësisht shumë vështirësive me të cilat përballen, megjithatë ka pranuar një numër të madh të punëtorëve në punë. Pas intervistimit me gojë dhe me shkrim, nga rreth 800 aplikues, komisioni përkatës ka përzgjedhur 230 më të suksesshmit, por që pas publikimit të emrave të punëtorëve të pranuar në punë banorët e

Shalës së Bajgorës kanë shfaqur pakënaqësitë e tyre.

Ibrahimi: Me gjithë vështirësitë prodhimi në "Trepçë" është rritur për 20 për qind

Menaxhmenti i "Trepçës" prej përfundimit të luftës një ndër problemet ka theksuar numrin e vogël të punëtorëve, respektivisht të minatorëve, shumica prej të cilëve ishin të vjetër në moshë. Menaxhmenti i "Trepçës" ka kërkuar vazhdimisht të pranohen në punë fuqi e re punëtorëve, para së gjithash të rinj, fëmijë të minatorëve. Në këtë mënyrë disa prej tyre ishin pranuar në punë në "Trepçë", por nuk kishte mjaftuar për t'i përmbushur të gjitha nevojat. Kombinati "Trepça" ka vite që po përballen me probleme të mëdha financiare për shkak të keqmenaxhimit disaveçar në vazhdimësi nga menaxhmenti, të cilat janë cilësuar si politike. Në shtatorin e vitit të kaluar kishte dështuar tenderi prej 17.6 milionë eurosh për shitjen e koncentratit për tetor, nëntor dhe dhjetor, ngase nuk është arritur marrëveshja për nënshkrimin e kontratës sipas kritereve të dosjes së tenderit dhe të propozimit të kontratës së publikuar në dosjen e tenderit. Për shitjen e koncentratit të plumbit dhe të zinkut "Trepça" ka kontratë me kompaninë zvicerane "Glencore International AG". Drejtori menaxhues i "Trepçës", Basri Ibrahim, ka thënë se pa investime milionëshe vështirë se "Trepça" do të mund të funksionojë. "Trepça" ballafaqohet me shumë probleme, duke filluar nga punëtorët e vjetër që vetëm deri në vitin 2022 duhet të pensionohen rreth 250 veta, që do të thotë se ata janë 63-vjeçarë dhe kontributi i tyre në minierë vihet në dyshim pasi duhet të ketë një forcë fizike. Kur e kemi parasysh edhe teknologjinë e vjetërsuar, kjo e vështirëson edhe më shumë situatën", ka thënë Ibrahim, i cili për fund ka bërë të ditur se në vitin 2019 prodhimi në "Trepçë" është rritur për 20 për qind. "Prodhimi është rritur për 20 për qind, por nuk e kemi arritur atë që kemi synuar sepse vështirësitë dhe problemet janë shumë të mëdha", ka thënë mes tjerash drejtori menaxhues i "Trepçës", Basri Ibrahim. "Trepça" pa pjesën veriore numëron 1.240 punëtorë.

Bota

Pasardhësja e Merkelit heq dorë nga kandidatura për kancelare

Zonja Kramp-Karrenbauer, e cila është edhe ministre e Mbrojtjes, u zgjodh si drejtuese e partisë konservatore të zonjës Merkel në dhjetor 2018 dhe ishte pritur gjerësisht ta pasojë atë si kancelare, sepse të dyja rolet tradicionalisht shkojnë paralelisht në Gjermani

Pasardhësja e kancelares Angela Merkel, Annegret Kramp-Karrenbauer, tha të hënën se do të largohet nga funksioni i kryetares së partisë CDU dhe nuk do të jetë kandidatë për kancelare të Gjermanisë, duke shtuar pasigurinë politike në demokracinë më të rëndësishme të Evropës.

Njoftimi pasoi pas pesë ditësh të trazirave politike, pasi në shtetin lindor të Tyringenit befaz u zgjodh kryeministër një kandidat i liberalëve (FDP) dhe kjo ndodhi me votat e disa deputetëve të CDU-së, të liberalëve dhe të partisë ekstremiste Alternativa për Gjermaninë (AfD), duke shkaktuar një protestë kombëtare. Ky hap erdhi në kundërshtim me një urdher të drejtpërdrejt nga znj. Kramp-Karrenbauer, e cila si drejtuese e partisë kishte dhënë udhëzime të qarta për të mos bashkëpunuar me Alternativën për Gjermaninë në çfarëdo niveli.

Rrëmuja në Tyringen

Zonja Kramp-Karrenbauer, e cila është edhe ministre e mbrojtjes, u zgjodh si drejtuese e partisë konservatore të zonjës Merkel në dhjetor 2018 dhe ishte pritur gjerësisht ta pasojë atë si kancelare, sepse të dyja rolet tradicionalisht shkojnë paralelisht në Gjermani. Ajo do të mbetet si drejtuese e partisë deri në verë, derisa të gjendet një zëvendës.

Por qëkur u bë udhëheqëse e partisë, znj. Kramp-Karrenbauer kishte humbur në mënyrë të qëndrueshme mbështetjen në sondazhet e opinionëve. Rrëmuja në Tyringen tregoi se deri ku ishte dëmtuar autoriteti i saj dhe ky vendim hap përsëri garën për kandidatë të tjerë për të pasuar znj. Merkel si kancelare.

Disa kandidatë të mundshëm janë duke pritur me padurim, më i spikatur është Friedrich Merz, i cili humbi me rezultat të ngushtë ndaj zonjës Kramp-



Karrenbauer në konferencën e partisë 2018, por është i popullarizuar në krahun konservator të Unionit të Kristian-demokratëve. Z. Merz tha këtë muaj se ai do të tërhiqet nga puna e tij në financa për t'u rikthyer në politikë me orar të plotë. Një tjetër pretendues i mundshëm është Armin Laschet, udhëheqësi i centrist i North-Rhine Westphalia, shteti më i populluar i Gjermanisë. Një ish-ministër i ri i integritit dhe një mbrojtës i palëkundur i politikës së refugjatëve të znj. Merkel, Laschet shihet si kandidati i vazhdimësisë. Ai nuk e hodhi kapelën në ring në konferencën e partisë, por ai ka lënë të nënkuptohet se do të ishte "i disponueshëm".

Atentati i parë politik i së djathtës ekstreme

Në klimën aktuale politike kriza në Tyringen ia ka dhënë dorëheqjes së zonjës Kramp-Karrenbauer një rëndësi të veçantë simbolike. Ajo ka refuzuar kategorikisht punën me Alternativën për Gjermaninë, e cila zakonisht njihet nga akronimi i saj gjerman, AfD. Në qershor ajo akuzoi AfD-në për krijimin e "klimës intelektuale", në të cilën një ekstremist i ekstremit të djathtë e qëlloi dhe e vrau Walter Lübckenin, një zyrtar i qeverisë rajonale, në atë që ishte atentati i parë politik i së djathtës ekstreme në Gjermani që nga Lufta e Dytë Botërore.

Zonja Kramp-Karrenbauer ka thënë se kushdo që luan me idenë për të punuar me AfD-në "duhet të mbyllë sytë dhe të imagjinojë Walter Lübckenin".

Partia e ekstremit të djathtë ishte e shpejtë për të përshëndetur dorëheqjen e saj si fitore. Alexander Gauland, një drejtues i lartë i partisë, përshëndeti njoftimin e znj. Kramp-Karrenbauer si një shenjë se nuk kishte më konsensus brenda Demokratëve të Krishterë për izolimin e AfD-së. "Është krejtësisht e pakuptimtë dhe mashtruese të mos duash të punosh me AfD-në në një afat të gjatë", tha z. Gauland. "Rrënjët e partisë e kanë kuptuar prej kohësh këto", raporton "New York Times".

Stuhia "Ciara" shkakton kaos në Evropë

Stuhia "Ciara" shkaktoi kaos në disa shtete të Evropës, me erëra deri në 180 kilometra në orë dhe me shira të rrëmbyeshëm. Stuhia zbarkoi fillimisht të dielën në Britani të Madhe, për të vazhduar më pas në pjesë të tjera të kontinentit.

Në Britani të Madhe një person humbi jetën, transporti rrugor u çrregullua

tërësisht, ndërsa fluturimet dhe shërbimet e trenave u vonuan dhe u anuluan.

"'Ciara' po dobësohet, por kjo nuk do të thotë se po hjmë në një periudhë më të qetë të motit", tha Alex Burkill, nga Zyra Meteorologjike e Britanisë.

Në jug të Suedisë autoritetet raportuan të hënën për një person të vdekur dhe një tjetër të zhdukur si pasojë e

përmbytjes së anijes së tyre.

Tre persona u plagosën rëndë në Gjermani, pasi u goditën nga drunjtë.

Në disa pjesë të Francës Veriore autoritetet ngritën alarmin e portokalltë, duke i paralajmëruar qytetarët për kushte të këqija të motit, që mund të kenë ndikim të keq te ta.

Stuhia shkaktoi anulimin e 240

fluturimeve të dielën në Aeroportin e Shipolit në Amsterdam, ndërsa po aq u anuluan edhe të hënën, transmeton REL-i.

Një person është plagosur nga një dru edhe në Republikën Çeke, ku stuhia ka lënë rreth 100.000 shtëpi pa energji elektrike. Nga stuhia u goditën edhe Belgjika dhe Luksemburgu.

K



ART

Në një intervistë për gazetën "Zëri" Dardan Noka, drejtor artistik i festivalit, shpalosi detaje nga programi i sivjetmë. Edhe pse thekson se ende po ballafaqohen me probleme të njëjta si 15 vjet më parë, ai zotohet se kanë përgatitur një program festiv. Ky edicion i 15-të i DAM-it hapet e mbyllet me koncerte, që i dedikohen 250-vjetorit të lindjes së Beethovenit me këtë bashkëpunim me Gyan

"DAM Fest"-i gati për edicionin e 15-të, shënon edhe 250-vjetorin e lindjes së Beethovenit

Liridona Ahma

Marsi sjell në Prishtinë edicionin e 15-të të festivalit "DAM Fest". Të gjithë adhuruesit e muzikës klasike duhet të rumbullaksojnë datat 24-28 mars 2020 për të marrë pjesë në koncertet që ky festival prezanton sivjet.

Në një intervistë për gazetën "Zëri" Dardan Noka, drejtor artistik i këtij festivali, shpalosi detaje nga programi i sivjetmë. Edhe pse thekson se ende po ballafaqohen me probleme të njëjta si 15 vjet më parë, ai zotohet se kanë përgatitur një program festiv. Ky edicion i 15-të i DAM-it hapet e mbyllet me koncerte, që i dedikohen 250-vjetorit të lindjes së Beethovenit.

Zëri: Këtë pranverë "DAM Fest"-i shënon edicionin e 15-të. Duke lënë pas 14 edicione të suksesshme, i 15-ti mund të shihet edhe si festë. Çfarë keni përgatitur deri tani për këtë edicion special?

Ky vit për DAM-in është festë. Jemi munduar të kemi një program që do të lërë shijen e një përvjetori të rëndësishëm, ani se ballafaqohemi me probleme të njëjta sikurse 15 vjet më parë. Problemet janë të shumta dhe as faqet e një numri të tërë gazete nuk do të mjaftonin për t'i numëruar ato. Sidoqoftë, këtë herë po shpalos më shumë një pjesë të programit, duke lënë anash për një çast problemet. Hapja dhe mbyllja e festivalit janë rezervuar për përvjetorin e madh të Beethovenit. Tashmë kemi hyrë në vitin ku gjithë bota shënon 250-vjetorin e lindjes së gjenit klasik, kështu dhe ne kemi menduar të jemi pjesë e festës, duke e nisur festivalin e 15-të me koncertin e

DAM FESTIVAL

Jusuf Buxhovi dhe Ramadan Musliu diskutojnë për "Shekullin e mbrapshtë shqiptar"

1

Kuитоime që kjo trilogji përfshin romanet: "Vdekjet e kolonelit", "Kujtimet e zonjës Von Braun" dhe "Kodi i dashurisë" (fitues i "Crimit Kombëtar për Letërsi" në vitin 2006)

Për librin "Trilogjia gjermane" e Jusuf Buxhovit, i cili është promovuar së fundi, tashmë do të mbahet një bisedë e hapur. Temë e bisedës do të jetë "Shekulli i mbrapshtë shqiptar" në "Trilogjinë gjermane" të Jusuf Buxhovit, që doli së voni nga shtypi.

Biseda moderohet nga Iliriana Hasaj.

Kujtojmë që kjo trilogji përfshin

romanet: "Vdekjet e kolonelit", "Kujtimet e zonjës Von Braun" dhe "Kodi i dashurisë" (fitues i "Crimit Kombëtar për Letërsi" në vitin 2006).

Romanet veç e veç janë botuar në vitet 2005-2006, ndërsa përfshirja e tyre në kuadër të "Trilogjisë gjermane" ka të bëjë me një përpunim letrar përbrenda një koncepti të përbashkët tematik, që i ndërlidh.



ansamblit austriak "Wiener Kammer-symphonie" dhe me pianistin kosovar Men-nan Bërvenikun, i cili jeton e vepron në Vjenë. Mbyllyjen ia kemi besuar violinistit të shquar shqiptar Tedi Papavramit, i cili në Prishtinë do të luajë i shoqëruar nga pianisti eminent francez François-Frederic Guy.

Zëri: Sipas jush, çfarë do ta bëjë këtë edicion të DAM-it më të veçantë se edicionet e tjera?

Përveç asaj që përmenda, do të ngelemi te prezantimet, përmes së cilave tentojmë ta sjellim muzikën klasike në një formë tjetër të përfaqësimit. Pjesë të rëndësishme do të zërë interpretimi i veprave të shek. XX dhe të shek. XXI nga ansambli rezident i festivalit "Oerknal" (Holandë) në bashkëpunim me disa prej muzikantëve më të dalluar kosovarë të gjeneratës së re. Po ashtu do të prezantohen edhe instrumentistët, të cilët do të luajnë në instrumente që jo shpesh mund t'i hasim në skenën kosovare.

Zëri: Në cilat lokacione sivjet do të mbahen mbrëmjet muzikore të "Dam Fest"-it. Sa po e vuani mungesën e një salle koncertale?

Festivali do të lëvizë në disa lokacione: Salla e Kuqe e Pallatit të Rinisë, Amfiteatri i Bibliotekës Universitare, Klubi i Boksit dhe Fondacioni 17 për Ligjëratat dhe Prezantimet.

Zëri: Cila është vështirësia më e madhe me të cilën përballen organizatorët e një festivali të muzikës klasike në Kosovë? Sa jeni të kënaqur me përkrahjen institucionale?

Ende nuk është rregulluar çështja e

mbështetjes. Skema e pavarur nuk ka as lehtësime në pikëpamje administrative, të taksave dhe mbështetja, edhe ajo që është, vjen gjithmonë problematike, e vonuar dhe është dëbuese e jo mbështetëse. Skena e pavarur shihet si barrë, si shpenzim në sytë e institucioneve dhe donacionet më shumë jepen si lëmoshë sesa si mbështetje serioze për një zhvillim të mirëfillt të skenës. Pastaj Kosova ka edhe limitet e veta në qasjen e fondeve jashtë vendit. Skena e pavarur gjendet në të njëjtin nivel, mu aty ku ka qenë para 15 vjetësh. Gjërat kanë lëvizur pak. Shpresoj që në mandatin 4-vjeçar të qeverisë së re gjërat të marrin drejtimin e duhur.

Zëri: Përveç DAM-it, ka edhe një seri festivalesh të muzikës klasike, që mbahen në pranverë. Është e qartë se publiku nuk ju mungon. Si e vlerësoni kontributin që organizime të kësaj natyre japin për jetën kulturore në vend?

Disa vite më parë njëri nga ministrat e Kulturës pati marrë ca vendime skandalozë, që për qëllim kishin shkatërrimin e skenës së pavarur kosovare. Pavarësisht dëmit, kjo nuk u arrit. Imagjinojeni Prishtinën pa festivale dhe pa aktivitete të skenës së pavarur. Çka ofron Prishtina, përveç kafeneve? Festalet dhe skena e pavarur e vënë në lëvizje Prishtinën dhe i japin sharmin që ajo ka. Personalisht as që dua ta imagjinoj Prishtinën pa skenën kulturore, të tillë besoj e duan banorët e saj, të cilët këtë e shpërfaqin me interesimin që kanë për t'u dhënë jetë e ngjyrë ngjarjeve që zënë vend në shtëpinë e tyre të përbashkët.



Filmi jugkorean "Parasite" triumfon në "Oscar"

Të dielën në Los Angeles të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është mbajtur ceremonia e ndarjes së çmimeve "Oscars 2020".

Filmi jugkorean "Parasite" është zgjedhur filmi më i mirë i vitit në ceremoninë e sivjetme "Oscars", duke u bërë filmi i parë me gjuhë joangleze që fiton çmimin kryesor.

Renee Zellweger ka fituar çmimin për aktoren më të mirë për rolin e Judy Garlandit në "Judy". Joaquin Phoenix u shpall aktori më i mirë për rolin e tij në filmin "Joker". Brad Pitt dhe Laura Dern fituan çmimet për aktorët më të mirë përkrahës për rolet në "Once Upon A Time in Hollywood" dhe "Marriage Story".

"Parasite" fitoi katër çmime në total, përdërisa "1917" mori tri çmime. Filmi i Luftës së Parë Botërore ishte favorit për të fituar çmimin kryesor, por çmimet që ai mori ishin në kategoritë teknike.

"Parasite" i Bong Joon-hos mori çmimin edhe për regjinë më të mirë, por edhe për skenarin më origjinal.

Filmi është një satirë sociale për dy familje nga klasa të ndryshme në Seul – një që jeton në varfëri në një bodrum dhe një tjetër e pasur, që jeton në një shtëpi të madhe.

Si kolona zanore më e mirë në këtë mbrëmje u shpall "(I'm Gonna) Love Me Again" nga Rocketman. Për makijazhin dhe stilin "Oscar" mori filmi "Bombshell".

Në anën tjetër me "Oscar" për efektet vizuale u shpërblye filmi "1917". Oscars për

editimin më të mirë mori "Ford v Ferrari", kurse me "Oscar" për kinematografinë më të mirë u shpërblye Roger Deakins për filmin "1917".

Filmi "1917" gjithashtu mori "Oscar"

për miksimin më të mirë të zërit.

Çmimin si aktorja më e mirë në rolin dytësor "Oscar" e mori Laura Dern për paraqitjen te filmi "Marriage Story". Sa u përket dokumentarëve, "Learning to Skateboard in a Warzone" (If You're a Girl) u shpërblye si dokumentari më i mirë i shkurtër, kurse "American Factory" si dokumentari më i mirë i gjatë. Për dizajnin e produksionit u shpërblye filmi "Once Upon a Time...in Hollywood". Në mesin e filmave të animuar si më i miri u cilësua "Toy Story 4".

Rikujtojmë se "Oscar" është një çmim që jepet nga organizata e filmografisë amerikane "Academy of Motion Picture Arts and Sciences" për përsosurinë profesionale në industrinë e filmit, duke përfshirë këtu regjisorët, aktorët dhe shkrimtarët. Ceremonia zyrtare, në të cilën bëhet ndarja e çmimeve, është ndërsa nga ceremonitë e ndarjes së çmimeve më të shquara në botë dhe jepet drejtpërdrejt në televizion në më shumë se 200 vende çdo vit. Ajo është gjithashtu në ceremonia më e vjetër e ndarjes së çmimeve në medie, ekuivalentet e saj, "Grammy Awards" (për muzikë), "Emmy Awards" (për televizion) dhe "Tony Awards" (për teatër), janë modeluar pas "Academy Award"-it.

2

* Çmimin si aktorja më e mirë në rolin dytësor "Oscar" e mori Laura Dern për paraqitjen te filmi "Marriage Story". Sa u përket



KONKURS për ANËTAR TË PAVARUR TË BORDIT TË DREJTORËVE

Në BPB, punojmë me vendosmëri dhe dedikim për të ndihmuar klientët dhe komunitetin ku jetojmë. Si banka më e mirë në vitet 2018 dhe 2019, e zgjedhur nga prestigjiozja "The Banker", ne jemi një nga institucionet financiare më të respektuara, inovative dhe të suksesshme të vendit. Qëllimi ynë strategjik është të mbështesim zhvillimin e ekonomisë dhe bizneseve të Kosovës. Prandaj, ne krijojmë marrëdhënie të shëndosha dhe afatgjata me klientët përmes vlerave tona - besimit, ndershmërisë, integritetit, transparencës, përgjegjësisë dhe komunikimit të hapur.

BPB është në kërkim të anëtarëve për Bordin e Pavarur të Drejtorëve me qëllim të një organi efikas për të zbatuar strategjinë afatgjate të bankës dhe praktikant më të mira të qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për strategjinë e biznesit dhe qëndrueshmërinë financiare të bankës, strukturën dhe praktikën e brendshme të Bankës, përcaktimin e pozitive kritike, qeverisjen korporative si dhe detyrimet e menaxhimit të rrezikut dhe pajtueshmërisë. Si anëtar/anëtare i/e Bordit të Drejtorëve, funksioni dhe përgjegjësitë duhet të ushtrohen me besim dhe profesionalizëm ndaj bankës dhe akcionarëve. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, janë përgjegjës të sigurojnë që Banka menaxhohet në atë mënyrë që ruan sigurinë dhe qëndrueshmërinë afatgjate, duke marrë parasysh interesat e të gjitha palëve të interesit përfshirë akcionarët, depozituesit dhe palët e tjera të interesit, sipas ligjeve dhe rregullores në fuqi si dhe standardeve mbikëqyrëse.

KËRKESAT DHE KUALIFIKIMET KRYESORE

- Diplomë universitare në Ekonomi, Financa, Juridik ose fusha të tjera relevante. Individët me kualifikim pasuniversitar ose MBA kanë përparësi;
- Njohuri të konsiderueshme dhe të pakten pesë (5) vite përvojë pune lidhur me: strategjinë e biznesit, menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut dhe pajtueshmërinë, kornizat dhe metodologjitë e qeverisjes korporative, të fituara në role të menaxhimit të lartë në institucione bankare dhe jo-bankare;
- Në gjendje të dedikojë kohë dhe përpjekje të mjaftueshme për të marrë pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në mbledhjet e Bordit;
- Person me qasje strategjike dhe inovative si dhe njohuri të gjerë për industrinë bankare;
- Afësi për të identifikuar sfidat dhe mundësitë kryesore përbrenda zgjidhjeve teknologjike të bankës, dhe të hartojë politika të përshatshme për të përcaktuar parametrat brenda të cilave duhet të operojë institucioni;
- Demonstron kuptimin e rëndësisë së punës ekipore në suksesin e bordit, duke përfshirë aftësinë për të njohur dhe vlerësuar kontributin e anëtarëve të bordit, stafit dhe palëve të interesuara;
- Aftësitë të natyrshëm për të kultivuar marrëdhënie profesionale dhe për të bindur, mbledhur, lehtësuar dhe ndërtuar konsensus midis individëve të ndryshëm;
- Aftësi për të nxitur ndryshime;
- Reputacion kredibil, nivel të lartë të integritetit dhe ndershmërisë;
- Demonstron gjykim të drejtë dhe të pavarur edhe nën presion;
- Flet dhe shkruan rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Për një përshkrim të plotë të përgjegjësisë dhe kërkesave kryesore, ju lutemi klikoni në linkun e më poshtëm <https://www.bpbank.com/banka/#karriera>

Profesionistët e interesuar për të kontribuar në suksesin e BPB si anëtar të Bordit të Drejtorëve duhet të dërgojnë një CV në gjuhën angleze në email adresën: boardnominations@bpbank.com.

Data e fundit për aplikim është 28 shkurt 2020.

Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë.



CALL for INDEPENDENT BOARD MEMBER POSITION

At BPB, we are passionate about helping customers and the communities where we live and work. As the best Bank in 2018 and 2019 according to "The Banker", we are one of the country's most respected, innovative and successful financial institutions.

Our strategic goal is to support the development of Kosovo's economy and businesses. Therefore, our focus is to create sound and long-term relations with the customers through our values - trust, honesty, integrity, transparency, open communication and responsibility.

BPB is looking to appoint **Independent Board Members** aiming to compose an efficient body to deliver on its long-term strategy and best practice of corporate governance.

The board has ultimate responsibility for the bank's business strategy and financial soundness, key personnel decisions, internal organization and governance structure and practices, and risk management and compliance obligations. The Board of Directors and its individual members ensure that the BPB is managed in a way that preserves its safety and sustainability, by operating in a way that takes into account the interests of all stakeholders under applicable national laws and supervisory standards.

KEY REQUIREMENTS:

- University degree in Economics, Finance or Law or other relevant fields of studies. Master Degree or EMBA would be an asset;
- Considerable knowledge and at least five (5) years of experience of best practice in business strategy, financial management, risk management and compliance, corporate governance frameworks and methodologies, gained in senior management roles within a financial institution or international banking environment;
- Able to commit the sufficient time and efforts to regularly and actively attend Board meetings, be prepared before the meeting by reviewing the necessary relevant materials;
- A strategic and innovative thinker with a hands-on approach and strong business acumen;
- Strong ability to identify key issues and opportunities within the technology solutions, and develop appropriate policies to define the parameters within which the organisation should operate;
- Demonstrate an understanding of the importance of teamwork to the success of the board, including an ability to recognize and value the contributions of board members, staff, and stakeholders;
- A natural affinity for cultivating relationships and persuading, convening, facilitating, and building consensus among diverse individuals;
- A politically savvy leader with ability to drive change;
- Reputable, demonstrated high level of integrity, honesty and independence of mind;
- Ability to demonstrate excellent judgement under pressure;
- Fluent written and spoken English.

For a full description of the main responsibilities and key requirements, please follow the following link to the website of Banka per Biznes <https://www.bpbank.com/banka/#karriera>

The professionals interested to contribute in the success of BPB as Directors should send a comprehensive CV in English to the dedicated email address: boardnominations@bpbank.com.

Closing date for applications is 28 February 2020.

All applications will be treated with the strictest confidence



KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, në Prizren

NJOFTON

Kompania Rajonale e Ujësllësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren **anulon** Konkursin për plotësimin e vendit të punës: Teknik - Mekanik ITUZ, 2 (dy) në Njësinë Punuese në Prizren e shpallur me datën 15.01.2020, në shtypin ditor "Zëri".

Kompania Rajonale e Ujësllësit
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren

OBAVESTENJE

Regionalna Kompanija za Vodovod "Hidroregjioni Jugor" D.D. u Prizrenu **ponistava** konkurs za popunu radnog mesta: Tehničar – mehanicar ITOV, 2 (dva) Radna Jedinica u Prizrenu koji je objavljen dana 15.01.2020 u dnevnoj stampi "Zëri".

Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidroregjioni Jugor" D.D. Prizren



KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, në Prizren

NJOFTON

Kompania Rajonale e Ujësllësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren **anulon** Konkursin për plotësimin e vendit të punës: Automekanik, 1 (një) në Njësinë Punuese në Prizren e shpallur me datën 14.01.2020, në shtypin ditor "Zëri".

Kompania Rajonale e Ujësllësit
"Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren

OBAVESTENJE

Regionalna Kompanija za Vodovod "Hidroregjioni Jugor" D.D. u Prizrenu **ponistava** konkurs za popunu radnog mesta: Mehaničar, 1 (jedan) za Radnu Jedinicu Prizren koji je objavljen dana 14.01.2020 u dnevnoj stampi "Zëri".

Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidroregjioni Jugor" D.D. Prizren

SPORT

Pioli, i zemëruar me lojtarët e Milanit
Faqe 17

Basketboll Klubit serb i ndalohet hyrja në Kosovë

15

Futboll Beshiktashi "peshkon" në Kosovë falë Remzi Ejupit

14

Futboll Rikthehet Superliga me derbin Drita - Gjilani

15



14

Vazhdojnë polemikat rreth FFK-së, Agim Ademi takohet me klubet e pakënaqura të Superligës

Klubet e Superligës së Kosovës në futboll do ta zhvillojnë të martën (sot) një takim me presidentin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Klubet e pakënaqura të Superligës, sipas trajnerit dhe donatorit të Llapit Tahir Batatinës, do të kërkojnë në këtë takim që pas ndeshjeve të Përfaqësueses së Kosovës në muajin mars të përfaqësohen në Komitetin Ekzekutiv të FFK-së. Sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu, deklaroi se FFK-ja është e hapur t'i dëgjojë të gjitha kërkesat e klubeve

Spor



KATËR MEDALJE EVROPIANE PËR KARATENË

E diela ishte dita e karateistëve kosovarë. Tre garues tanë arritën të stolisën me medalje të bronzë nga kampionati evropian "Budapest 2020", që u mbajt për grupmoshat kadetë, juniorë dhe U-21. Të tre garuesit: Albulena Gërvalla, Vesa Ibrahim dhe Benjamin Shabani, fituan medaljet e bronzta në grupmoshën U-21, njofton Komiteti Olimpik i Kosovës. Sukses arriti edhe Djellza Sejdijaj, që shënoi dy fitore, ndërsa garuesit tjerë u ndalën kryesisht në luftën e parë dhe të dytë. Një ditë më parë Betim Maliqi kishte fituar po ashtu të bronzën për juniorë (kategoria -68 kg). Karateja u përfaqësua në Evropian me 29 garues.

Rikthehet Superliga me derbin Drita – Gjilani

Futbolli kosovar është rikthyer në aksion pas një pushimi rreth dymujor. Ndeshjet e Digitalb Kupës së Kosovës kanë hapur edicionin pranveror, ndërsa në fundjavë do të zhvillohet edhe java e 18-të në Ipko Superligë.

Në këtë javë do të luhet edhe derbi i madh lokal mes Dritës dhe Gjilanit, që është vendosur të dielën, me fillim nga ora 13:00.

Kjo është njëra ndër ndeshjet më interesante në elitën e futbollit kosovar e që ngjall interesim të jashtëzakonshëm jo vetëm tek adhuruesit e futbollit në Anamoravë, mirëpo në të gjithë Kosovën.

Kjo ndeshje do të jetë shumë interesante, pasi të dyja skuadrat në këtë edicion po luftojnë për titullin kampion.

Gjilani ndodhet i dyti në tabelë me 32 pikë të grumbulluara, dy më pak se lideri Ballkani, ndërkohë që Drita zë vendin e tretë me një pikë më pak, 31.

Lideri aktual Ballkani e nis rrugëtimin në pranverë me përballjen e së shtunës, me ç'rast në shtëpi e pret skuadrën e Drenicës.

JAVA E 18-TË NË IPKO SUPERLIGË

E shtunë

Ballkani – Drenica 13:00
Prishtina – Vushtrria 13:00
Ferizaj – Feronikeli 13:00

E diel

Drita – Gjilani 13:00
Flamurtari – Trepça '89 13:00
Dukagjini – Llapi 13:00

TABELA

1. Feronikeli	9	7	2	0	20:5	23
2. Prishtina	9	5	3	1	9:4	18
3. Llapi	9	5	1	3	16:8	16
4. Flamurtari	10	4	4	2	13:12	16
5. Drenica	10	4	3	3	12:9	15
6. Trepça '89	10	3	5	2	15:9	14
7. Gjilani	9	4	2	3	9:8	14
8. Drita	9	3	1	5	13:15	10
9. Ferizaj	9	3	1	5	5:11	10
10. Liria	10	3	0	7	15:21	9
11. Ballkani	9	2	3	4	8:11	9
12. KEK-u	9	0	1	8	10:32	1

Ballkani i prin tabelës me 34 pikë, teksa Drenica zë pozitën e gjashtë me dhjetë pikë më pak (24).

Dy ndeshjet tjera të ditës së shtunë janë Prishtina me Vushtrrinë dhe Ferizaj me Feronikelin, sfida këto që priten me shumë interes.

Ndërkohë të dielën, përveç derbit gjilanas, do të zhvillohen edhe dy ndeshjet tjera, Flamurtari – Trepça '89 dhe Dukagjini – Llapi.



Vazhdojnë polemikat rreth takohet me klubet e pak

Shpatmal Krasniqi

Futbolli kosovar nuk po mund të gjejë qetësi. Klube të Superligës së Kosovës në futboll vazhdojnë të kenë pakënaqësi me mënyrën e udhëheqjes së Federatës së Futbollit të Kosovës.

Më 27 janar të vitit të kaluar disa klube kosovare kërkuan të bëhen ndryshime në statutin e FFK-së, ku kërkuan të përfaqësohen në Komitetin Ekzekutiv. Një gjë e tillë nuk u miratua, ndërkohë që anëtarët të KE-së u zgjodhën kryetarët e lidhjeve rajonale të futbollit.

Me 37 vota pro është zgjedhur Komiteti Ekzekutiv i ri për katër vjetët e ardhshëm.

Komiteti Ekzekutiv i ri i FFK-së u votua nga më shumë se 50 për qind e delegatëve, që ishin në sallë. Kuvendin Zgjedhor i FFK-së nisi me tensione. Anëtarët e KE-së të FFK-së janë: Bakir Burri, Agim Dibrani, Predrag Jovic, Xhelal Broja, Mirsad Qollaku, Naser Ajeti, Iljaz Mjaku, Vjollca Krasniqi, Flamur Bunjaku, Ismajl Ajeti dhe Agim Nura. Ata kanë mandat katërvjeçar. Pa u votuar rendi i ditës në Kuvendin Zgjedhor për anëtarët të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së pati përplasje mes kryetarit Agim Ademit dhe disa prej delegatëve të klubeve të Superligës. Ademi kërkoi mocion votëbesimi nga delegatët e pranishëm në Kuvend, por kundërshtimet ishin të mëdha nga delegatët e Llapi, të Trepçës '89, të Ballkanit e të disa të tjerave.

Pas shumë diskutimeve kreu i FFK-së nuk u lejua të kërkohet mocion votëbesimi nga delegatët për mandatin e tij.

Tahir Batatina: Nëse nuk realizohen kërkesat tona do të largohemi nga garat

Presidenti i Federatës së Futbollit të

"Ne do ta bojkotojmë Kampionatin nëse nuk realizohet një gjë e tillë. Prishtina, Llapi, Ballkani, Drenica dhe Ferizaj janë për ndryshime", Tahir Batatina, trajner dhe donator te klubi i Llapi.



Kosovës, Agim Ademi, të martën (nesër) në orën 14:00, në zyrat e FFK-së, do të takohet me klubet e Superligës së Kosovës në futboll.

Ky takim zhvillohet pas shumë polemikave, që ishin në Kuvendin Zgjedhor për Komitet Ekzekutiv të FFK-së, të zhvilluar më 27 janar e ku disa klube të Superligës shprehin pakënaqësi të shumta me këtë Komitetet, duke kërkuar që ato të përfaqësohen në KE.

I kontaktuar nga gazeta "Zëri", trajneri i Llapi dhe donatori i këtij klubi, Tahir Batatina, e ka konfirmuar takimin.

Batatina thotë se klubet në këtë takim do t'i kenë dy kërkesa. "Do të kërkojmë si film që mbarëvajtja e kampionatit të shkojë në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi dihet se mund të këtë parregullsi. Kërkesa jonë e dytë është që ne klubet e Superligës të përfaqësohemi në Komitetin Ekzekutiv, pasi në këtë mënyrë mund t'i kontrollojmë mjetet tona financiare. Për shkak të Përfaqësueses së Kosovës në futboll do të kërkojmë që një gjë e tillë të ndodhë pas

FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS I SHPALL LAUREATËT E VITIT

Pingpong

Federata e Pingpongut e Kosovës vazhdon traditën e shpalljes së pingpongistëve më të mirë të vitit 2019, si dhe do të ndajë mirënjohje për kontribute të ndryshme në sportin e pingpongut, njofton kjo Federatë. Ceremonia "Laureatët 2019" do të mbahet të shtunën, më 15 shkurt, nga ora 18:00, në hotelin "Venus", në Prishtinë. Kjo është hera e 17-të që Federata ndan mirënjohje për lojtarët e pingpongut që nga pranimi i FPPK-së në federatën ndërkombëtare. Pjesë e ceremonisë do të jetë edhe presidentja e Federatës Botërore, Petra Sorling, e cila po e viziton Kosovën për



herë të parë, me rastin e turneut për Ditën e Pavarësisë. Po ashtu nënkryetari i Unionit Evropian të Pingpongut, Ivo Goran Munivra, do të jetë pjesë e ceremonisë. Komisioni ka bërë përzgjedhjen e sportistëve dhe të sportistëve më të dalluar të vitit 2019, si për moshat madhore, ashtu edhe për gjeneratat e reja, që janë shpresa e pingpongut, përveç lojtarëve më të mirë, ka bërë përzgjedhjen edhe për punëtorin e vitit, gjyqtarin vendor dhe ndërkombëtar të vitit, trajnerin e vitit etj. Po ashtu do të ndahen edhe disa mirënjohje të veçanta, të cilat do të shpallen të shtunën

Agim Ademi dhe FFK-së, Agim Ademi kënaqura të Superligës



ndeshjeve të Kosovës në muajin mars, që janë shumë të rëndësishme dhe nuk duam që në këtë kohë të shkaktojmë trazira", ka thënë Tahir Batatina për gazetën "Zëri".

Ai ndër të tjera tha se nëse nuk realizohet një kërkesë e tillë gjashtë klube të Superligës do të largohen nga garat. "Ne do ta bojkotojmë Kampionatin nëse nuk realizohet një gjë e tillë. Prishtina, Llap, Ballkani, Drenica dhe Ferizaj janë për ndryshime", potencoi Tahir Batatina.

Në pyetjen e gazetës se kush e ka thirrur këtë takim, Batatina tha se takimi është thirrur nga Agim Ademi.

Eroll Salihu: Do t'i dëgjojmë kërkesat e klubeve

Gazeta ka tentuar të bisedojë edhe me presidentin e FFK-së Agim Ademin, mirëpo telefoni i tij nuk kishte qasje.

Ndryshe, takimin në fjalë e ka konfirmuar sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu.

Fakte

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të martën (nesër) në orën 14:00, në zyrat e FFK-së, do të takohet me klubet e Superligës së Kosovës në futboll. Ky takim zhvillohet pas shumë polemikave që ishin në Kuvendin Zgjedhor për Komitet Ekzekutiv të FFK-së, të zhvilluar më 27 janar e ku disa klube të Superligës shprehin pakënaqësi të shumta me këtë Komitetet, duke kërkuar që ato të përfaqësohen në KE.

Ai ka deklaruar se në këtë takim janë të ftuara të gjitha klubet e Superligës. "Ky është takim i zakonshëm, që gjithmonë bëhet para fillimit të Kampionatit. Ne do t'i dëgjojmë dhe do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat e klubeve. Jemi të hapur për një gjë të tillë", ka deklaruar Eroll Salihu.

Beshiktashi "peshkon" në Kosovë falë Remzi Ejupit

Beshiktashi nis "peshkimin" në Prishtinë për talentet e së ardhmes dhe ka filluar duke siguruar pasardhësin e Loris Kariusit në katërkëndësh. Klubi i njohur turk ka siguruar një marrëveshje bashkëpunimi me klubin e Prishtinës dhe sipas medieve turke njëra nga pikat e këtij bashkëpunimi përfshin edhe gardianin e kësaj skuadre, Visar Bekaj. Mediet turke sqarojnë se Bekaj duhet të transferohet te Hoffenheimi në Gjermani, por marrëveshja dështoi për shkak të dokumentacionit. Megjithatë, paraqitet e tij kanë tërhequr vëmendjen e Beshiktashit, i cili do të finalizojë në verë transferimin e gardianit, që është pjesë edhe e përfaqësueses së Kosovës. Për 22-vjeçarin kjo është mundësia e artë e karrierës për të shkuar në një kampionat më të fortë, gjë të cilën e kërkon prej shumë vitesh. "Falë presidentit

Remzi Ejupit na është mundësuar të kemi bashkëpunim me një klub të madh si Beshiktashi. Ky klub e ka ndjekur Visar Bekajn në fazën përgatitore në Turqi. Në bisedën me drejtorin sportiv e kam parë se ky klub ka nevojë për portier. Shpresoj se Bekaj do t'u bashkohet në fund të edicionit", ka thënë Armend Dallku, trajner i Prishtinës.

Ndërkaq klubi turk do të hapë një shkollë futbollit në bashkëpunim me Prishtinën në Kosovë, si dhe do të huazojë në radhët e skuadrës së drejtuar nga Armend Dallku talentet e saj, që nuk kanë hapësira të aktivizohen me klubin e Superligës turke.

Presidenti i Prishtinës Remzi Ejup dhe presidenti i Beshiktashit Ahmet Nur Çebi muajin e kaluar u takuan në Stamboll dhe u dakorduan për bashkëpunim të ngushtë në të gjitha fushat.



Klubit serb i ndalohet hyrja në Kosovë

Klubit të basketbollit nga Serbia, Sloge, i është ndaluar hyrja në territorin e Kosovës, ka konfirmuar zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Daut Hoxha.

Hoxha ka thënë për gazetën se klubi serb nuk kishte marrë leje paraprake nga autoritetet kosovare për t'u futur brenda territorit të Republikës së Kosovës, prandaj edhe i është ndaluar hyrja të hënën në mëngjes.

"Ekipi në fjalë nuk ka pasur leje nga ministria kompetente, prandaj edhe i është refuzuar hyrja në Republikën e Kosovës", ka thënë Hoxha për "Zërin".

Basketbollistët e Slogës u kthyen mbrapsht nga Policia e Kosovës në pikën

klufitare në Jarinë.

Kjo nuk është hera e parë që Slogës i ndalohet hyrja në Kosovë. Muajin e kaluar klubi nga Batocine ishte kthyer nga kishte ardhur për të njëjtat arsye.

Ky është vetëm rasti i fundit në një varg ndalesash që Policia kosovare ua bën klubeve serbe të sportit, të cilat qëllimshëm përpigjen të futen në territorin fqinj për të zhvilluar ndeshje garuese me klubet serbe të Kosovës pa kërkuar leje dhe duke i shkelur rregullat.

Qëllimi i klubit nga Batocine ishte zhvillimi i një ndeshjeje të ligës së dytë serbe të basketbollit në veri të Mitrovicës kundër klubit të ashtuquajtur Treçpa.

Sport

Lukaku: Jam këtu për të fituar

Romelu Lukaku thotë se Interi demonstroi mentalitetin e fortë pas rikthimit ndaj Milanit në derbin e qytetit. Interi ishte në disavantazh prej dy golash në pjesën e parë, por arriti ta përmbyste rezultatin dhe të triumfojë në fund me shifrat 4:2. Repreruesi belg, i cili shënoi golin e katërt për zikaltrit, u shpreh se ka ardhur në Inter për të fituar. "Ne

bëmë shumë mirë gjatë pjesës së dytë. Ata luajtën mirë gjatë pjesës së parë sepse ne u lamë shumë hapësirë dhe vuajtëm", u shpreh Lukaku, i cili shënoi golin e tij të 17-të në kampionat ndaj Milanit. "Sidoqoftë, ne u kthyem mirë nga pushimi. Ne kompletuam rikthimin dhe jemi të lumtur me fitoren. Mendoj se të gjithë e kanë parë mentalitetin e



kësaj skuadre, ne kurrë nuk heqim dorë dhe ne gjithmonë kërkojmë të fitojmë. Unë jam këtu për të fituar dhe synimi im i vetëm është ta ndihmoj ekipin për t'i marrë rezultatet. Dua t'i falënderoj të gjithë tifozët, bashkëlojtarët e mi, zotin Conte dhe të gjithë stafin e tij për përkrahjen që janë duke ma dhënë", shtoi ai.

Pioli, i zemëruar me lojtarët e Milanit

Trajneri i Milanit, Stefano Pioli, ka thënë se ndihet i zemëruar me lojtarët e vet, të cilët i kritikon se nuk i kryen detyrat e veta në mbrojtje, duke e lejuar Interin të rikthehet nga 2:0 për të fituar 4:2 të dielën në derbin lokal.

Kuqezinjtë e dominuan Interin në pjesën e parë, duke e krijuar një epësi prej 2:0 falë Zlatan Ibrahimovicit, i cili asistoi për Ante Rebicin dhe pastaj shënoi edhe vetë në "Giuseppe Meazza".

Por Interi u rikthye nga rrënojat për të fituar 4:2 falë golave nga Marcelo Brozovic, Matias Vecino, Stefan de Vrij dhe Romelu Lukaku. "Strategjia jonë funksionoi shumë mirë në pjesën e parë dhe mbase meritoni më shumë se 2:0. Por pasi i pranuan dy gola brenda tre minutave gjithçka ndryshoi", tha Pioli. "Jam i zemëruar me lojtarët e mi, sepse ata kishin detyra mbrojtëse në ato situata dhe në momentin që nuk i kryem u ndëshkuam nga Interi", shtoi italiani.



Ibra: E vështirë ta shpjegosh çfarë ndodhi

Zlatan Ibrahimovic e ka të vështirë ta shpjegojë sesi Milani i tij u mposht

4:2 nga Interi, edhe pse po udhëhiqte 2:0 pas pjesës së parë në derbin e Milanos të dielën. Sulmuesi suedez ishte vendimtar në pjesën e parë, duke asistuar për golin e Ante Rebicit para se të shënonte vet, por lojtarët zikaltër përmbysen gjërat dhe ia siguruan fitoren 4:2 Interit në pjesën e dytë. "Është e vështirë ta shpjegosh se çfarë ndodhi. Në

"Është e vështirë ta shpjegosh se çfarë ndodhi. Në pushimin mes pjesëve i thamë vetes sonë se 15 minutat e parë në pjesën e dytë do të jenë vendimtarë dhe në atë periudhë 15-minutëshe ne i pësuam dy gola", Ibrahimovic

pushimin mes pjesëve i thamë vetes sonë se 15 minutat e parë në pjesën e

dytë do të jenë vendimtarë dhe në atë periudhë 15-minutëshe ne i pësuam dy gola", tha Ibrahimovic për "Sky Sport Italia". 38-vjeçari mendon se kuqezinjtë nuk besuan në fitore në pjesën e dytë. "Ne u ndalëm, ekipi nuk besoi më, nuk bëri presion më dhe nuk e lëvizti topin përreth mjaftueshëm. Pas barazimit çdo gjë dështoi", shtoi ai.

Fakte

Milani ishte duke fituar 2:0 ndaj Interit pas pjesës së parë, por zikaltrit në fund triumfuan 4:2 pas katër golave të shënuar në pjesën e dytë

1

ZIDANE KËRKON MË SHUMË GOLA NGA ISCO

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, kërkon të shohë më shumë gola nga Isco, pasi mesfushori shënoi për herë të parë këtë edicion në La Liga në fitoren 4:1 ndaj Osasunas të dielën. Isco shënoi për barazimin 1:1, para se madrilenët të arrijnë një fitore të lehtë për të arkëtuar 3 pikët e radhës. Zidane lavdëroi paraqitjen e repreruesit spanjoll,



por tha se dëshiron që ai të jetë më shpesh në listën e golashënuesve. "Nuk mendoj se ka ndryshuar ndonjë gjë. Isco është një lojtar i rëndësishëm në këtë skuadër", tha Zidane. "Ai pati një ndeshje brilante si gjithë të tjerët, por mbi të gjitha jam i lumtur për golin e tij, sepse ai ka nevojë të shënojë më shumë gola", shtoi ai.

2

CAVANI ËSHTË MË I FORTË PAS DËSHTIMIT PËR T'U LARGUAR

Trajneri i Paris Saint-Germainit, Thomas Tuchel, thotë se Edinson Cavani është më i përqendruar pas dështimit për t'u larguar nga klubi parisien gjatë afatit kalimtar të janarit. Cavani, i cili do të mbetet pa kontratë në fund të këtij edicioni, dëshoi të largohej nga klubi francez gjatë muajit të kaluar, por tentativa e tij për të shkuar në Atletico Madrid dës-

htoi. Ndërkohë, uruguaiani hyri nga banka rezervë në fitoren 4:2 ndaj Lyonit të dielën dhe shënoi gol pas vetëm 3 minutave. "Kurdo që ka konkurrencë është mirë. Ne kemi nevojë për të gjithë lojtarët. Unë gjithmonë e kam thënë këtë. Ju mund ta ndjeni që Edi është më i fortë në stërvitje momentalisht, sepse gjërat janë të qarta pas merkatos", tha Tuchel.

Ndeshjet e Premierligës dhe të futbollit amerikan, koncertet dhe meçet e boksit - stadiumi i Tottenhamit është kthyer në një industri

Stadiumi i ri i Tottenhamit, me vlerë prej 1 miliard funtësh, ka qenë një sukses i vërtetë, derisa ka hapur dyert para vetëm një viti. Tashmë është kthyer në stadiumin numër një për industrinë sportive dhe argëtuese.

Anthony Joshua dëshiron ta bëjë meçin e ardhshëm aty, derisa bendi legjendar "Guns N' Roses" do të performojë në muajt në vijim

Kur Tottenham Hotspuri e kompletoi shpërnguljen e shumëpritur në stadiumin e ri prej një miliard funtësh në edicionin e kaluar, ata u bënë zilia e çdo tifozit sportiv në botë. Sidoqoftë, "White Hart Lane" ishte i mirë, por stadiumi i ri "Tottenham Hotspur" është në një nivel krejt tjetër. Me një kapacitet prej mbi 62.000 ulësesh, e ka ngritur shumë nivelin në aspektin e pajisjeve dhe tash pritet të jetë nikoqiri i sporteve të ndryshme dhe evenimenteve argëtuese krahas ndeshjeve në Premierligë.

Derisa një tjetër nivel artistik i stadiumeve është ndërtuar në vitet e fundit, me një tjetër pak më poshtë në "Emirates", asnjë nuk e ka pasur ndikimin e Tottenhamit në "Tottenham High Road".


Arena është ndërtuar për të qenë në gjendje të mbajë evenimente të ndryshme të botës së sportit dhe të medias, me fushën palosëse të llojit të parë në Mbretërinë e Bashkuar. Ndeshja e parë e futbollit ishte mbajtur më 24 mars të vitit të kaluar, një ekip i ri i Tottenhamit triumfoi 3:1 ndaj Southamptonit. Emri i J'Neil Bennetit do të mbetet në histori për shkak se ai shënoi golin e parë në histori të stadiumit.

Pak muaj më vonë, në tetor, ajo pjesë e Londrës Veriore e shijoi për herë të parë një ndeshje të futbollit amerikan, kur Oakland Raiders fitoi ndaj Chicago Bears para 60.463 shikuesish, para se Carolina Panthers ta mposhtë Tampa Bay Buccaneers një javë më vonë.

Në pushimet e pjesëve të para tifozit i njohur i Tottenhamit, AJ Tracey, doli në skenë për të performuar para shikuesve, duke u bërë artisti i parë që shfaqet në pushim të pjesës së parë në ndeshjet e Londrës. Ai gjithashtu e hapi rrugën për artistët e tjerë, derisa legjendat e rokut "Guns N' Roses" do të performojnë në muajt në vijim.

Banda u reformua në 2016-n dhe janë duke bërë një turne evropian në 2020-n, në të cilën do të bëjnë histori duke

Derisa klubet e tjera në Premierligë, Arsenali dhe Manchester City, sa për t'i përmendur dy, kanë hapur stadiume të reja që prej fillimit të shekullit, asnjëra nuk e ka pasur ndikimin si të Tottenhamit.



bërë muzikë të gjallë për herë të parë në stadiumin "Tottenham Hotspur".

Derisa klubet e tjera në Premierligë, Arsenali dhe Manchester City, sa për t'i përmendur dy, kanë hapur stadiume të reja që prej fillimit të shekullit, asnjëra nuk e ka pasur ndikimin si të Tottenhamit.

Ka hapur një rrugë të re, për suksese të reja, një nivel të përvojës artistike, si për tifozët e futbollit dhe për dashamirët e muzikës. Stadiumet si "Etihad" kanë qenë nikoqire të bendeve të mëdha dhe të artistëve që prej hapjeve të tyre, por Tottenhami ka bërë hapa përpara me ndoshta arenën më të mirë në botë.

Në fakt, lista e evenimenteve në vijim duket e pafund, derisa unioni dhe liga e ragbit pritet të jenë në aksion. Klubi ka siguruar një partneritet të gjatë me gjigantin e ragbit Saracens, derisa do të shfaqin ndeshjet e tyre vjetore për pesë vjet, duke filluar në 2020-n. Edhe pse klubi do të bjerë në kategorinë e dytë për shkak të skandalit me paga, fama e tyre është ende e madhe dhe stadiumi pritet të jetë i mbushur ndaj Harlequins në mars.

Në 2021-n ragbi do të vazhdojë me European Rugby Champions Cup dhe me finalat e Challenge Cup.

Vijat gjithashtu do të ngjyrosen për një ndeshje të ligës së ragbit në nëntor të këtij viti, derisa testi i tretë dhe ai final në serinë e 2020-s do të jetë mes Anglisë dhe Australisë.

Në mes të botës së sportit dhe argëtimit qëndron boksi, edhe pse nuk është konfirmuar ende, ky është një tjetër sport që pritet të zërë vend në këtë stadium në vitet në vijim.

Kush tjetër mund ta fillojë trashëgiminë e boksit sesa vendori Anthony Joshua. Ai ka luftuar në "Wembley", por ylli i peshave të rënda nuk ka treguar se ku dëshiron ta çojë karrierën e tij. Joshua e mposhti Ruiz Jr për t'u kthyer në rrugën e duhur në luftën e fundit dhe promotori Eddie Hearn së fundmi ka folur për destinacionin e meçit të ardhshëm, që pritet të ndodhë në muajt në vijim. "Ne kemi pasur oferta nga Lindja e Largët, Lindja e Mesme, Afrika, Amerika, Turqia. Ai dëshiron të luftojë në Londër në qershor. 'Spurs' është favorit dhe

kjo është ajo që ma ka kërkuar ai të bëj. Ai ma ka bërë të qartë mua, 'Unë dua të kthehem në shtëpi', ka thënë Hearn.

Dhe pra, ja ku është. Harrojeni "Wembley"-n, harrojeni "Emirates"-in, Joshua dëshiron "Tottenham Hotspur"-in. Kush mund ta fajësojë? Derisa pajisjet në arenat tjera janë të shkëlqyeshme, ato janë shumë më të mira në "Tottenham Hotspur".

Një lokal i madh prej 65 metrash qëndron në tribunat kryesore. Është më i madhi në Evropë dhe do t'i shërbente më shpejt se çdokush tjetër tifozët e Joshuas. Ulëset janë më të rehatshme, akustika më impresionuese. Boksi është një spektakël dhe "Tottenham Hotspur" do ta mirëpriste më mirë se kushdo tjetër.

Me të vërtetë stadiumi është primar në aspektin argëtues në Londër momentalisht. Edhe pse me shpenzime të mëdha, vendimi i Tottenhamit për ta përmirësuar stadiumin ka sjellë triumfe dhe klubi mund të ndihet krenar për stadiumin, që është më i miri në botë.

Marija
Piskac



02

Kroatja Marija Piskac me bukurinë dhe me trupin e saj seksi shumë shpejt e ka pushtuar botën e modës.



Me foto lakuriqe sërish zemëron babanë

Ireland Baldwin, vajza e aktorëve të famshëm Alec Baldwin dhe Kim Biesinger, shpesh në rrjetet sociale publikon foto lakuriqe, edhe pse është e vetëdijshme se me këtë e zemëron pa masë babanë e saj të famshëm. Tani sërish e ka përsëritur të njëjtën gjë, duke publikuar një foto të saj në një kostum larjeje tejet provokues, nën të cilin i duken qartë gjinjët, ndërsa poza nga sauna vërtet tërheq vëmendjen për të pasur mendime jo edhe aq të dinjitetshme. Kjo bukuroshe vitin e kaluar ka pozuar e veshur vetëm në brekë tanga në ballkonin e saj dhe atëherë Alec kishte reaguar publikisht. "Më fal... Çfarë?!", i kishte shkruar ai nën foto. Ireland në një rast kishte publikuar një foto, në të cilën shihet duke hipur mbi motoçikletë dhe me këtë rast ka treguar vithet e saj të zhveshura, ndërsa Baldwin atëherë ia kishte

Kjo bukuroshe vitin e kaluar ka pozuar e veshur vetëm në brekë tanga në ballkonin e saj dhe atëherë Alec kishte reaguar publikisht

bërë me dije se paraqitje të tilla nuk i pëlqejnë aspak. "Jo. Vetëm... Jo", kishte komentuar ai. Mirëpo ajo disa herë kishte deklaruar se nuk turpërohet që të foto-grafohet lakuriqe, ndërsa për raportin e brishtë me babanë e saj nuk kishte folur deri kohë më parë. Më saktësisht, deri para vdekjes së basketbollistit Kobe Bryant, kur ka deklaruar se kjo e ka shtyrë të mendojë për lidhjen e serishme me babin e saj. "Të dytë kemi kaluar nëpër një periudhë të vështirë. Është dashur shumë kohë dhe terapi për t'i shëruar plagët", ka shkruar ajo.

Larg alkoolit dhe drogës

Në mesin e të famshmëve mund të bëhet edhe një përzgjedhje. Kriteri këtë herë është moskonsumimi i pijeve alkoolike. Shumë figura të famshme, sikurse janë Blake Lively dhe Kristin Davis, nuk e kanë të vështirë t'i thonë "jo" këtij vesi të keq, ndërsa ata të cilët nganjëherë lëshojnë pe, sikurse Jennifer Lopez, nuk e bëjnë këtë nga kënaqësia. Ja çfarë thonë disa prej tyre për alkoolin. Jennifer Lopez kënaqet në shumë gjëra, por jo edhe në alkool. "Mendoj se alkooli i bën dëm lëkurës sime. Natyrisht se kur festojmë diçka nuk mund ta bëj këtë me ujë, por në këto raste pi vetëm pak", thotë Jennifer Lopez. "Nuk pi alkool. Nuk e kam provuar kurrë drogën. Nuk kam nevojë për gjëra të tilla", ka thënë Blake Lively. Aktorja Kim Cattrall tha se nuk i duuron sasi të mëdha të alkoolit. "Nuk i duroj sasi të mëdha të alkoolit dhe kur pi më dhemb koka. Nuk pi, nuk drogohem, kështu që vetëm rrobat më

përmirësojnë disponimin", shprehet Kim Cattrall. As Bradley Cooper nuk është adhurues i alkoolit. "Më nuk pi alkool dhe nuk konsumoj drogë. Të jesh i kthjellët është një gjë e madhe. Isha në prag të shkatërrimit të vetvetes", ka thënë aktori Bradley Cooper. Kristin Davis e ka lënë alkoolin në moshën 20 vjeçe, pasi e kishte kuptuar se pija po ia rrezikonte karrierën. "Nuk ia vleme rreziku, sepse gjërat po keqësoheshin", ka thënë ajo. Matthew Perry kishte probleme të mëdha me varësinë ndaj alkoolit, por në fund ka arritur të triumfojë. "Tani me krenari mund t'u them të tjerëve se lënia e alkoolit është e mundur", ka thënë Perry. Aktorja Jennifer Hudson kurrë nuk ka pirë alkool, edhe pse kolegët e saj e përdornin atë. "Natyrisht si aktore ekzistojnë gjëra me të cilat duhet të përballësh. Nuk e dija se si është ndjenja të kesh vese të këqija dhe nuk kam dashur të kem një ndjenjë të tillë", ka thënë ajo.



1
MODELJA E FITNESSIT QË KA MBI 24 MILIONË NDJEKËS

Njihuni me bukuroshen Sommer Rey. Kjo modele e fitnessit në profilin e saj në rrjetin social "Instagram" ka më shumë se 24 milionë ndjekës, të cilët rregullisht e përcjellin dhe me kënaqësi komentojnë fotot e saj lakuriqe. Ajo më së shpeshti publikon foto të nxehta nga palestra ku ushtron, por gjithashtu jep edhe këshilla se si të arrini format e përkryera të trupit, siç i ka edhe ajo dhe duhet pranuar se nuk është aspak e lehtë për ta arritur

këtë. Sommer ka edhe kanalën e saj në "YouTube", në të cilin rregullisht publikon instruksione për ushtrime, ndërsa gjithashtu ka edhe linjën e saj të modës, e cila përfshin kostume të larjes dhe veshje të brendshme seksi. Përndryshe, Sommer në shumicën e topistave për femrat më seksi të "Instagram"-it është ngjitur lart, kjo falë vërtet një trupi fantastik, të cilin asnjëherë nuk përton ta ekspozojë sa herë që i jepet mundësia.

2

Përveç shifrave marramendëse që fiton nga koncertet, albumet dhe ofertat private, mbretëreshës së muzikës pop Madonnas i është ofruar edhe një mundësi e jashtëzakonshme. Në të vërtetë këngëtarja ka marrë ofertë të këndojë në dasmën e një miliarderi kinez në Shanghai. Ai është i gatshëm që paraqitjen e saj të paguajë hiç më pak se tre milionë

dollarë. Nga këngëtarja pritet që në dasmën, e cila organizohet në orët e mbrëmjes, të mbajë një shfaqje prej 1 orësh e gjysmë, ndërsa të sapomartuarit do ta kenë mundësinë ta hartojnë listën e hiteve të saj. menaxherët e Madonnas e kanë mbajtur këtë ofertë të hapur, përderisa ajo vetë nuk vendos nëse do ta pranojë ose jo. Ta refuzosh një ofertë të tillë duhet të jesh e çmendur.

Merr ofertë në vlerën 3 milionë dollarë për vetëm një mbrëmje



SASIA

Aktorja Kim Cattrall
tha se nuk i duron
sasitë e mëdha të
alkoolit

5 E portokallta dhe roza si një kombinim ngjyrash janë supermoderne. Përzjerja e nuancave të spikatura vërtet tërheqin vëmendjen dhe gjithsesi se do të bëjnë një ekspozim. Për të na treguar se si bëhet kjo është përkujdesur Issa Rae, e cila kishte veshur këtë fustan "Edana" nga shtëpia e modës "Solace London" dhe mendojmë se ajo duket e mrekullueshme. Dekolteja e thellë dhe materiali simetrik i rrudhosur kompletojnë ngjyrat e çelura, për ta bërë këtë fustan aq atraktiv, sa të gjitha shikimet do të jenë të drejtuara te ju. Kombinojeni me aksesore metalikë sikurse Issa për të pasur një pamje të sofistikuar dhe moderne.



Solace
London
650 €



Biondja fatale krahason seksin me futbollistët dhe me filozofët

Maglietti i është kërkuar të krahasojë romancën me futbollistë me romancat me filozofë, sepse ajo kishte dashnorë nga të dyja këto fusha

Bukuroshja Alejandra Maglietti, ish e dashura e yllit të dikurshëm të ekipit Njukasëll, Jonas Gutierrez, ka nxjerrë detaje interesante nga jeta e tyre kur ishin së bashku, lidhje kjo që ishte e mbushur me momente të bukura, por edhe të tmerrshme. Biondja superseksi ka folur haptazi për jetën e saj intime me futbollistin argjentinas. Maglietti i është kërkuar të krahasojë romancën me futbollistë me romancat me filozofët, sepse ajo kishte dashnorë nga të dyja këto fusha. "Filozofi do të zgjaste më pak në seks, por në anën tjetër do të bënim seks më shpesh, ndërsa futbollistët do të zgjasnin më shumë në seks, por ne do të bënim seks shumë

më pak. Filozofi do të bisedonte me mua rreth Friedrich Nietzsches. Gjithmonë do të fliste për të, edhe ashtu i ka pëlqyer shumë Nietzsche", thotë biondina. Bukuroshja dhe legjenda e Njukasëllit janë ndarë në vitin 2019, pas pesë vjetësh bashkëjetese, mirëpo Maglietti i kishte qëndruar pranë ish-futbollistit gjatë betejës së tij me kancerin e testitëve. "Ishte me mua gjatë momenteve më të vështira të jetës sime. I dëshiroj gjithë të mirat, gjithmonë do ta kujtoj me shumë dashuri", kishte deklaruar Gutierrez për mediet lokale. Përndryshe, bukuroshja njihet për imazhin e saj provokues, duke publikuar foto të nxehta në rrjetet sociale.

3

PËR HERË
TË PARË SË
BASHKU NË
PUBLIK

Manekinia dhe aktorja në ngritje Camila Morrone dy vjetët e fundit është në lidhje me njërin prej meshkujve më të dëshiruara të Hollywoodit, Leonardo DiCaprio, mirëpo, çifti në të kaluarën nuk është mundur të shihet bashkë në publik. Fotot e tyre të vetme kur shihen bashkë janë ato të paparacëve, ndërsa edhe në qilimin e kuq të çmimeve "Oskar" nuk kanë pozuar bashkë. Mirëpo në rendin e parë janë ulur pranë njëri-tjetrit, në mesin

e elitës së Hollywoodit, çka shumica e ka konsideruar si një hap të madh në lidhjen e tyre. Leo dhe Camila janë argëtuar mirë gjatë kësaj mbrëmjeje, mirëpo aktori nuk ka arritur të fitojë "Oskari"-n për rolin kryesor, pasi këtë çmim ka arritur ta fitojë Joaquin Phoenix për rolin e Jokerit. Duke marrë parasysh se Leonardo njihet si një maskull që i ndërron vazhdimisht femrat, duket se Camila ka arritur t'ia marrë zemrën tërësisht.

4

Scarlett Johansson ishte e nominuar për dy çmime "Oskar" këtë vit, por nuk arriti të fitojë asnjërën statujë. Mirëpo Scarlett ka shkëlqyer me një fustan të bukur me ngjyrë metalike, i cili ka zbuluar tatuazhet në shpinën e saj, ndërsa në ahengun tradicional të "Vanity Fair"-it ajo ka zbuluar tatuazhin nën gjinjtë dhe tjetrin në dorë. Scarlett në këtë vend të

ndjeshëm ka gdhendur një zog në fluturim, derisa në shpinën e saj ka tatuazhin e luleve. Pa dyshim se me paraqitjen e saj në këtë ceremoni ajo ishte njëra prej bukurosheve me stilin më të bukur, duke përfshirë edhe flokët dhe grimin që kishte zgjedhur. Kur i ke këto ndoshta çmimet bien në plan të dytë. Përndryshe, ajo në këtë ceremoni është paraqitur me bashkëshortin e saj.

Nuk e fitoi
"Oskar"-in, por të
gjithë flasin për
tatuazhet e saj

KIDZ

● Sa kushton qethja e flokëve?, e pyet njëri berberin. - 10 euro.
- E sa kushton rroja? - 5 euro ... - Ma rruaj kokën pra!



Luani dhe lepuri

Sipas të parëve, luani nuk e duron dot këngën e gjelit. Nuk dihet mirë nëse kikiriki-ja aq e njohur e tremb ose e mërzit mbretin e kafshëve.

Një ditë një lepur deshi të zbulonte të vërtetën. U paraqit te luani, ia bëri nderimet e duhura dhe drejt e në temë:

- Madhëri, këtej rrotull dëgjohej të thuhet se klithma e keqe dhe shungulluese e një gjeli të mjerë ju bën t'ia mbathni juve luanin e pathyeshëm. Çfarë mendon, madhëria juaj, për një gjezur të tillë?

- Mendoj se është e vërtetë, - iu përgjigj luani, pa hezituar. - Të gjithë e kemi nga një pikë të dobët: edhe pse, nga forca dhe përmasat,

dukemi sikur nuk kemi dobësi.

Dhe duke parë që lepuri mbeti me gojë të hapur, luani deklaroi nga fronti i lartë:

- Nga ana tjetër, jam i sigurt se ke dëgjuar që edhe elefanti ia mbath nga miu dhe që tmerrohet nëse në veshët e tij të mëdhenj, por delikatë, arrin hungërima e dërrit.

- Uaa! - u ngazëllye lepuri. - Tani e kuptoj përse ne lepujt ia mbathim të tmerruar kur dëgjojmë të lehurat e qenit!

- Madhëri, këtej rrotull dëgjohej të thuhet se klithma e keqe dhe shungulluese e një gjeli të mjerë ju bën t'ia mbathni, juve luanin e pathyeshëm. Çfarë mendon, madhëria juaj, për një gjezur të tillë?

FJALË E URTË
Kur gabon i mençuri çuditet budallai.

POEZI

Adem Jasharit

Sa herë përmendet
Si fshat Prekazi,
Aty veç dihet
Është Adem Jashari.

Ademi e dha jetën
Për liri të atdheut,
Duke mos iu trembur
Syri asnjëherë.

Nuk harrohet dot
Familja Jashari,
Që e dha jetën
Për Kosovë e para.

Armiqtë bënin çudi
Mbeteshin të befasuar,
Se si kjo familje
Luftonte duke
kënduar.

Gjersa më në fund
Ranë në fushën e
nderit,
Që populli shqiptar
Të jetojë i lirë
si të tjerët.

Selman Xh. Gashi

Fëmijë të dashur, ju mund të dërgoni punimet tuaja, të cilat mund të jenë në formë të poezisë, tregimit, vjershës, apo të ngjashme.

Adresa:
kidzzeri@gmail.com

Pinguinët, zogj që nuk fluturojnë

Pinguinët bëjnë pjesë në familjen e zogjve të ujtit që nuk fluturojnë. Pinguinët pjesën më të madhe të trupit e kanë të zezë, kurse barkun me ngjyrë të bardhë. Ata ushqehen me gaforre, peshq dhe me shtazë të tjera të detit, të cilët i gjuajnë derisa notojnë nën ujë. Nën ujë e kalojnë gati gjysmën e jetës së tyre. Edhe pse të gjitha llojet e pinguinëve kanë prejardhje nga hemisfera jugore, ata jetojnë kryesisht në hapësirat me klimë të ftohtë, sikur Antarktika, por ka edhe disa që jetojnë në vende të nxehta sikur



Galapagos, që jeton afër Ekuatorit. Lloji më i madh i pinguinit është pinguini perandorak, të cilët janë të lartë rreth 1.1 metra dhe të rëndë rreth 35 kg, ndërsa lloji më i vogël është pinguini xhuxh, që mbërrin lartësinë deri 40 cm dhe peshon rreth 1 kilogram.

Francezi në rolin e Super Marios

I pandalshmi dhe sypatremburi Remi Gaillard doli në rrugë i veshur si Super Mario, nga loja kompjuterike me të njëjtin emër. Ky shakaxhi vozitet rrugëve dhe nëpër qendrat tregtare me "veturën" e tij, mu sikur në lojën e famshme, hedh banane dhe zhguaj breshkash nga makina. Montazhi i përkryer po ashtu është pjesë magjepsëse e videove të tij të postuara në "YouTube". Të gjitha veprimet që bën gjatë filmit të shkurtër janë të përcjella me efekte zanore. Kur i harxhohen bananet, të

cilat i hedh nën automjete përreth vetes, Remi me veturë futet nëpër qendra tregtare dhe blen disa kilogramë fruta nëpër dyqane. Filmi përfundon me fjalët: "nëse mund të bëni ç'të doni, mund të jeni edhe secili".



Në trupin e njeriut muskuli më i fortë është gjuha.



NYTOR: ARBËRËSH DALIPI	I TEORISË	URANI	RIFAT GJOTA	INTERNATIONAL ORGANIZATION FOR MIGRATION	E BËJ TË BUTË	AKTORI KABASHI	SHALQI	ROMEQ	UNIVERSITY OF REGINA	TUFA E BLETËS KUR ROIT	TË LUTEM	ZBUKURIM ME LARA		L+L	ORGES TOÇE	CEP	INFORMUES
LLQJ I TURIZMIT													LLAÇI				
EDHE		GJOBITJE QË LIDHET ME FSHATRAT						QYTETAR I ROMËS SË LASHTE BONJAK						DHJETË (ANG.) AKTORI RAFUNA			
OREGON			MUROS SPICE SHUMË E HOLLË DRURI					MIK I AFËRT PËRKËDHËL							PETRIT FEJZULLAHU ORENDI PËR TË FJETUR		
HAJN GJERASH TË VOGLA				RRUGË QË HAPET NËN TOKE ANKUES					NIP BIMË BARISHTORE							OSE E ETSHME	
GJEMBAÇ					AI QË SHET DËCKA KËNGËTARI SHAQIRI					DËCKA E PANJOHUR FARKËTAR							
MBULESË ENE						I KIMISË LEHTË							THAHEM MOTOÇKLETE				
	I LARMË ZBRAZJET						NJËGJYMYTRËSH AKTORI DEAN							KËSTI AKTORI WILLIAMS			
BRAVO		LËVROJ VESHJE PËR KEMBËN						I PËRJAVSHËM KALLAMBOQ							I SHITIE TUTËN ÇELIKOS		
O. Ç.			PRODUKT MISHI ENË E THELLË METALI						PATAN MARR PËRSËRI							RHODE ISLAND INICIATIVA	
SHIKOJ				ISH-PRESIDENTI TOPI BAKTER I ZGJATUR SI SHKOPËTH						BARI ELEMENT KIMIK (RB)						VANADI REZULTATI PËR 5X2	
BANOR I ARABISË					ROB LUFTË (VJET.) HABIT						LIDH SËRISH DY PJESE TË NDARA RACOR						MBËRRITJE
PJESË E SIPËRME E DHOMËS						I SHKAKTOJ NJË SËMUNDJE ENDACAK						FILLIMI PIKTURË NË PELHURË					
I PATËMETË							KRYEQYTET I MAROKOS KËNGËTARJA ISTREFI						LLAHTARI PAZAR				
SOUTH		KËNGËTARI MUSHKOLAJ PËRDORËT KUR SHIPËRIM MOSPËRËLLJE						KAÇURRELAT Ë IMETA KAFSHE Ë MADIE PËRTPËSE						KALI I SHALES PARTI POLITIKE KOSOVARE			
KUNDREJT PO			E HA DËCKA ME LIMË UNITED NATIONS						KOMUNE NË MAGEDONINË VERIORE FITNETE TUDA						Ë. T. DY ZANORE		
PËRDORËT KUR SHIPËRIM MOSPËRËLLJE				FAREFIS X+H						AKTORI PRODANI NJËSHI ROMAK							XHUL FLUORI
LIDHJE E BAKRIT ME ZINKUN						AJO QË SHKRUAN ME MAKINË SHKRIMI											



SUDOKU

SITË LUANI: Çdo kolonë nëntëshifrore, vertikale apo horizontale dhe çdo bllok "3x3", duhet të përmbajë numrat prej 1-9. Secili numër është njëkohësisht pjesë e tri fushave të tilla dhe duhet të jetë i vetëm për të tria. Kjo do të thotë që, nëse diku keni një numër "2", ky numër nuk duhet të përsëritet më as në vijën e tij horizontale, as në atë vertikale, as brenda bllokut ku ndodhet.

I LEHTË ★☆☆

I MESËM ★★☆☆

I VËSHITËRË ★★★

		7				6		
7			1 3					
1	2				4			
								2
	6		9			7		
3								
	8			9			3	
			7 4					1
	9			5				

				9				
	5 9			1 2 6				
					4		5	
	3							1
				7				
5							4	
2	8							
		1 3 5			7 8			
			4					

			7					4
	9 1						5	
	7			2				1
		3						7
	8					2		
5				4				
3		2				8		
	4			9 5				
6			1					



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikanteve në Gjykata, për Praktikantë vullnetarë (pa pagesë) për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

shpall:

K O N K U R S

Nr. 1/2020

Për praktikantë vullnetarë:

1. Gjykata Themelore në Mitrovicë.....20 praktikantë
2. Dega Leposaviç5 praktikantë
3. Dega Zubin Potok.....5 praktikantë
4. Dega në Vushtrri.....20 praktikantë
5. Dega në Skenderaj.....15 praktikantë

Përshkrimi i detyrave të punës

Titulli i pozitës: Praktikantë

Nëpunësi mbikëqyrës: Administratori i Gjykatës dhe Nd. Administratorit

Detyra e praktikantit: Ndihej zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

Vepron në mbikëqyrjen e drejtëpërsëdrejti, të Kryetarit të Gjykatës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Administratorit të Gjykatës;

Ndihej punët në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;

Ndihej gjyqtarët në punë që kanë të bëjnë me futjen e lëndëve në dosje;

Ndihej në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet etj; Kryen edhe punë tjera sipas nevojës;

Kualifikimet:

Diploma e Fakultetit Juridik ose Master,

Njohuri të procedurave gjyqësore;

Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);

Njohuri të mjaftueshme ligjore;

Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin e shkrimit të draftëve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të prapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregulloren, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil dhe Udhëzimin Administrativ nr.2007/01
- Konkursi është publikuar më dt.11.02.2020 dhe mbyllet 25.02.2020.

- Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në Zyrën e Pranimit, si dhe në degën Leposaviç, Zubin Potok, Vushtrri dhe Skenderaj.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëprejt aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragraf 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranura vetëm kandidatët e përgjedhurë në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikatë të tjera, dy rekomandime etj.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiti dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.
- Në rast të ndonji pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtarë i/e personelit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

Na osnovu člana 4 Pravilnika o postupu zapoljavanja Pripravnika u Sudovima, za Pripravnike volontere (bez plaćanja) na određeno vreme, u trajanju od jedne godine.

OSNOVNI SUD U MITROVICI

Objavljuje:

K O N K U R S

Br. 1/2020

Za pripravnike volontere:

1. Osnovni sud u Mitrovici20 pripravnika.
2. Ogranak Leposavić5 pripravnika.
3. Ogranak Zubin Potok5 pripravnika.
4. Ogranak u Vučitrnu20 pripravnika.
5. Ogranak u Srbici15 pripravnika.

Opis radnih obaveza

Naziv pozicije: Pripravnik.

Nadgledajući službenik: Administrator suda i V.D. Administratora.

Zadatak pripravnika: Pomaže administrativnoj kancelariji u organizovanju i čuvanju predmeta, kao i njihovom upravljanju uopšte.

Glavni zadaci

1. Deluje pod direktnim nadzorom Predsednika Suda i pod opštim nadzorom Administratora Suda.
2. Pomaže u poslovima administrativnoj kancelariji u organizovanju i čuvanju predmeta, kao i njihovom upravljanju uopšte.
3. Pomaže Sudiji u radu u vezi stavljanja predmeta u dosje.
4. Pomaže u radu različitim kancelarijama Suda, obuhvatajući upisivanje, istrage, sudjenja idr. Obavlja i druge poslove po potrebi.

Kvalifikacije:

Diploma Pravnog fakulteta ili Mastera.

Poznavanje sudskih postupaka.

Sposobnost za obavljanje istraživanja sudskih (pravni).

Dovoljno pravnog znanja.

Odlučnu sposobnost u pismenom sastavljanju pravnih nacerta, obuhvatajući i sposobnost u sastavljanju pravnih dokumenata kao i komunikacijske veštine u govoru.

PRIMEDBE:

- Postupak Konkursa je otvoren za spoljašnje kandidate i postojećih državnih službenika.
- Postupak zapoljavanja se odvija prema predviđenom Zakonu o Državnoj službi Br-03/Z-149 i Uredbe Br.02/2010 o postupcima Zapoljavanja u Državnoj Službi i Administrativnog Uputstva br. 2007/01.
- Konkurs je objavljen dana 11.02.2020. godine i zatvara se 25.02.2020. godine.

- Aplikacije možete uzeti i dostaviti Osnovnom sudu u Mitrovici, u kancelariji za prijem kao i u Ogranak u Leposaviću, u Zubino, Potoku, Vučitrnu i u Srbici.

Kosovska Državna služba obezbeđuje jednake mogućnosti zapoljavanja za sve građane Kosova i prihvata dobro aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

- Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupanje u organima Državne službe u centralnoj i lokalnoj javnoj administraciji, kao što je navedeno u članu 11, stav 3 Zakona br. 03/Z-149 o Državnoj službi Republike Kosova.

Nakon isteka konkursa, Aplikacije neće biti prihvaćene. Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo uži izbor kandidata biće kontaktiran.

Pravo konkurisanja imaju svi stanovnici Kosova, uzrasta od 18-64 godina. Aplikacije treba da se jasno popune i da su čitljive. U aplikacijama treba da se upišu svi traženi podaci. Treba tačno da se odredi mesto i pozicija za koju se konkuriše. Uz Aplikaciju treba priložiti potrebna dokumenta za konkurisanje, kao što su: Kopija diplome o završenoj školi, različite stručne specijalizacije, uverenje o radnom iskustvu, druga uverenja, potvrde, dve preporuke i drugo.

Ako Aplikaciji ne priložite potrebna dokumenta i ne popunite ih sa tačnim podacima, Vi ćete sami izgubiti slučaj da budete u užoj listi.

- Fotokopije dokumenata priloženih u Aplikaciji, kandidati nemaju pravo da povuku nazad.
- U slučaju bilo kakvog pitanja ili nejasnoće, možete kontaktirati Kancelariju za osoblje.

SHPLLJE

- Emrush Tupani, Begrac – Kaçanik, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Kuvendi i Lezhës”, Viti.
- Durim Buzhalla shpall të pavlefshme certifikatën e SHM “11 Marsi”, Prizren.
- Emir Ibrahim shpall të pavlefshme diplomën e SHM “11 Marsi”, Prizren.
- Fadil Elezaj shpall të humbur certifikatën e furrarit, të lëshuar në QAP, Prishtinë, me nr. 892/2018 nga 10/01-22/01 2018.
- Fidan Januz Terziu, Pozhoran, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale “Jonuz Zejnuullahu”, Viti.
- Vesim paqarizi shpall të pavlefshme dëftesat I, II, III, IV, plus diplomën, gjimnazi “Jeta e Re”, Suharekë.
- Feti Sadiku shpall të pavlefshme diplomën e SHME “Kadri Kusari”, në Gjakovë.
- Albi Kurhasku shpall të pavlefshme diplomën e SHMM “Hysni Zajmi”, në Gjakovë.

Në lagjen “Dardania”, “Kurriz”, te tuneli, jepet me qira dyqani 26 m² + 16 m² nën kat.
Qiraja mujore 950 euro.
Për më tepër informata 00355/ 69214 3553 ose 00355 69 235 6179.



Lexo me Zë

VETËM PËR PËRKUJTIME

Për botimin e përkujtimeve vënie në Kosovë ose vënie në periferi.
Zëri ka këtu çmimet:

1/1 FAÇE	100 euro	1/4 FAÇE	30 euro
1/2 FAÇE	50 euro	1/8 FAÇE	20 euro



ALI KONJUHI

Sot, në këtë ditë, në këtë datë, të kujtoj me shumë mall, boll shumë u durova që lot të mos kem në sy. Po më mungon shumë, dua ta kthej kohën mbrapa, dua të jemi si përpara, ta shijoj atë kënaqësi që e pata, të dua babi im shumë.

E kujtojnë me mall: Familja nga Amerika, bashkëshortja Fahrija, djemtë: Sanija, Abdyli, Hyseni e Mergimi, vajzat: Shqipja e Mihonja.



**SHFLETO GAZETËN
ZËRI ONLINE**

**Gjithashtu në dispozicion në Smartfon dhe Tablet
€ 4.99 NË MUAJ € 23.40 NË 6 MUAJ € 34.80 NË VIT**



powered by



REGISTROHU TANI NË:
online.zeri.info

EARLY
BOOKING
VERA 2020



Në çmim janë të përfshira:

- Akomodimi në hotel me pansion të plotë
- Aviobiletë Prishtinë - Antalya - Prishtinë
- Transferi aeroport - hotel - aeroport
- Të gjitha taksat e aeroportit

eurokoha

**Wind Of Lara
Hotel & Spa**



Antalya ★★★★★
7 net / All Inclusive

529€

**Crystal Waterworld
Resort & Spa**



Belek ★★★★★
7 net / Ultra All Inclusive

535€

**Crystal Tat Beach
Golf Resort & Spa**



Belek ★★★★★
7 net / Ultra All Inclusive

575€

**Kirman Hotels Belazur
Resort & Spa**



Belek ★★★★★
7 net / Ultra All Inclusive

655€

Nova Beach



Side ★★★
7 net / All Inclusive

379€

Lyra Resort Hotel



Side ★★★★★
7 net / Ultra All Inclusive

440€

Valeri Beach Hotel



Kemer ★★★★★
7 net / All Inclusive

389€

Blue Wave Suite Hotel



Alanya ★★★★★
7 net / All Inclusive

350€

Për informata dhe rezervime na kontaktoni në
038 235 235 | eurokoha.eu

- Sheshi Nëna Terezë, Swiss Diamond Hotel,
- Vellusha e Poshtme 17
- Rruga Garibaldi, Hotel Grand